Demokratizimi
i Drejtësisë Tranzicionale

Drejt një Infrastrukture Diskutuese për Trajtimin e së Kaluarës në Kosovë

inTegra

NEW SOCIALINITIATIVE

PAX

www.paxforpeace.nl

Demokratizimi i Drejtësisë Tranzicionale

Drejt një Infrastrukture Diskutuese për Trajtimin e së Kaluarës në Kosovë

Gëzim Visoka dhe Besart Lumi

Impressum

Publikim nga PAX, Integra dhe Iniciativa e Re Sociale (NSI)

ISBN: 978-94-92487-53-7

PAX/2020/03

Qershor 2020

Autorët: Dr Gëzim Visoka & Besart Lumi

Fotografia e kopertinës: Foto nga projekti 'Të jetosh me kujtimet e të pagjeturve'

Foto nga: Atdhe Mulla

Përkthyer në shqip nga: Gazmend Bërlajolli

Faqosja: Het IJzeren Gordijn

MIRËNJOHJE

Për ndihmën profesionale dhe komentet thelbësore të ofruara, autorët falënderojnë Kathelijne Schenkel, Kushtrim Koliqin dhe Jovana Radosavljevic. Gjithashtu i jemi mirënjohës zonjës Guillemette Guicherd për ofrimin e të dhënave krahasuese për trajtimin e të kaluarës në shoqëritë e tjera të prekura nga konflikti. Dëshirojmë të falënderojmë edhe të gjithë individët që ndanë mendime dhe vështrime në intervista ose fokus grupe. Raporti përfitoi shumë edhe nga të gjitha sugjerimet e ofruara nga anëtarët e grupt të shoqërisë civile, përkatësisht: Igballe Rogova (Rrjeti i Grave të Kosovës), Bekim Blakaj (FDH Kosova), Shukrije Gashi (Partners Kosova), Dejan Radivojevic (FDMC Gracanica), Zana Syla (ADRC), Miodrag Milicevic (Aktiv), Mehmet Musaj (QRVT), Lazar Rakic (ADRC), Marigona Shabiu (YIHR Kosova) dhe Sara Salihu (MPRC). Në fund, jemi shumë mirënjohës për mbështetjen financiare të ofruar nga Fondi i Menaxhimit të Njohurive përmes Platformës së Njohurive mbi Sigurinë dhe Sundimin e Ligjit (Holandë).

PËR AUTORËT

Dr. Gëzim Visoka është Profesor i Asociuar i Studimeve të Paqes dhe Konfliktit në Universitetin e Qytetit të Dublinit (DCU) në Irlandë. Ai ka botime të shumta mbi Kosovën, drejtësinë tranzicionale dhe ndërtimin e paqes pas konfliktit. Z. Besart Lumi është aktivist për të drejtat e njeriut dhe drejtësinë tranzicionale me veprimtari në Kosovë. Ka mbaruar studimet MA në Zgjidhjen e Konflikteve nga Universiteti i Denverit, ShBA.

INTEGRA

Misioni i Integra-s është të ndihmojë zhvillimin e Kosovës, veçmas në kontekstin e të drejtave të njeriut dhe integrimit, duke trajtuar dhe promovuar rrëfime dhe përvoja të komuniteteve të margjinalizuara, duke kontribuar kështu në proceset e demokracisë, në ndërtimin e besimit dhe bashkëjetesën. https://ngo-integra.org/index.html

NISMA E RE SOCIALE

NSI është institucion i pavarur i studimeve dhe veprimeve nga Mitrovica e Veriut, i bazuar në idenë për të frymëzuar komunitetet dinamike në Kosovë. Misioni ynë është t'i ndihmojmë institucionet në përdorimin e anëve të forta të komunitetit dhe në marrjen e vendimeve të bazuara në prova, për të zgjidhur sfidat kryesore sociale dhe komunitare. http://newsocialinitiative.org/

PAX

PAX punon me qytetarë dhe partnerë të përkushtuar për të mbrojtur civilët kundër akteve të luftës, për t'i dhënë fund dhunës së armatosur, dhe për të ndërtuar paqe. PAX operon i pavarur nga interesat politikë.

Kutia postare 19318
3501 DH Utrecht, Holandë
info@paxforpeace.nl, www.paxforpeace.nl

Knowledge Management Fund | Knowledge Platform Security & Rule of Law

Tabela e përmbajtjes

Shkurtesat 6

Gjetjet kryesore 7

Hyrje 9

Metodologjia dhe të dhënat 12

Drejtësia pa Strategji: Pasqyrë e nismave për trajtim të së kaluarës në Kosovë (1999-2020) 13
- Gjykatat ndërkombëtare dhe hibride për krimet e luftës në Kosovë 14
- Nismat për kërkimin dhe dokumentimin e të vërtetës 19
- Dëmshpërblimet 24
- Garancitë e mospërsëritjes dhe reformat institucionale 25

Drejt një infrastrukture diskutuese për trajtimin e së kaluarës në Kosovë 32
- 1. Vizioni Strategjik dhe Mirëkuptimi Kombëtar mbi TsK 33
- 2. Depozitë e njohurive mbi drejtësinë tranzicionale 34
- 3. Zhvillimi i një strategjie kombëtare për TsK nga poshtë-lart dhe të përqendruar drejt viktimave 35
- 4. Drejt një infrastrukture institucionale për trajtimin e së kaluarës 39

Përfundim: Reflektime përtej Kosovës 43
- Mësimi 1: Nuk ka marrëveshje për paqe pa dispozita të drejtësisë tranzicionale 44
- Mësimi 2: Koha dhe vullneti politik janë thelbësore për suksesin e proceseve të drejtësisë tranzicionale 45
- Mësimi 2: Koha dhe vullneti politik janë thelbësore për suksesin e proceseve të drejtësisë tranzicionale 46
- Mësimi 4: Qasjet diskutuese ndaj TsK janë kyçe për tejkalimin e bllokimeve ndaj të vërtetës dhe drejtësisë 47

Shkurtesat

KMDLNj	Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut
KE	Këshilli i Evropës
BE	Bashkimi Evropian
EULEX	Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë
FDH	Fondi për të Drejtën Humanitare
I4P	Infrastruktura për Paqe
ICO	Zyra Civile Ndërkombëtare
ICTY	Gjykata Ndërkombëtare e Krimeve për ish-Jugosllavinë
GPNM-TKP	Grupi Punues Ndërministror për Trajtimin e të Kaluarës dhe Pajtimin
KFOR	Forcat e NATO-s në Kosovë
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
LKK	Libri i Kujtimit i Kosovës
QRVT	Qendra Rehabilituese e Kosovës për Viktimat e Torturës
DhSK	Dhomat e Specializuara të Kosovës
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
OJQ	Organizatat Joqeveritare
ZPZhML	Zyra për Personat e Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PACE	Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës
PK	Partners Kosova
RECOM	Komisioni rajonal për përcaktimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut
SITF	Task Force Hetuese Speciale
ZPSK	Zyra e Prokurorisë Speciale e Kosovës
KVP	Komisioni i së Vërtetës dhe Pajtimit
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

Gjetjet kryesore

- Njëzet e një vjet pas përfundimit të konfliktit të dhunshëm, Kosova nuk ka arritur ende të hartojë një strategji kombëtare për drejtësinë tranzicionale për shkak të mungesës së vullnetit dhe zotimit politik midis palëve të interesuara, kombëtare e ndërkombëtare, për t'u përfshirë mirëfilli me trashëgiminë e të kaluarës.

- Përkundrazi, nismat krah për krah të drejtësisë tranzicionale që vijuan, vuanin nga mungesa e bashkërendimit dhe harmonizimit, politizimi dhe personalizimi nga liderët politikë, dhe më e rëndësishmja nuk ia dolën të siguronin përfaqësim të mjaftueshëm dhe përfshirje të komuniteteve të prekura (viktimave dhe të mbijetuarve të konfliktit).

- Ky studim sugjeron se Kosovës i duhet një infrastrukturë e integruar dhe diskutuese për drejtësinë tranzicionale, që të sigurojë legjitimitetin dhe efikasitetin e përpjekjeve për trajtimin e të kaluarës në Kosovë.

- Studimi propozon një qasje me katër hapa, duke përfshirë:

  1. Gjenerimin e një mirëkuptimi kombëtar të informuar nga qytetarët mbi parimet dhe etikën e trajtimit të të kaluarës dhe të drejtësisë tranzicionale në Kosovë;

  2. Zhvillimin e një baze të integruar të njohurive dhe depozitimin e strategjive, iniciativave dhe mekanizmave ekzistues për sektorët specifikë të drejtësisë tranzicionale në Kosovë;

  3. Zhvillimin e një strategjie kombëtare nga poshtë-lart dhe të përqendruar drejt viktimave; si dhe

  4. Hartimin e një infrastrukture institucionale të integruar për trajtimin e së kaluarës.

- Përvoja e Kosovës ofron katër mësime përfundimtare: 1) nuk duhet të ketë marrëveshje të paqes pa dispozita të drejtësisë tranzicionale; 2) koha dhe angazhimi politik janë thelbësore për suksesin e proceseve të drejtësisë tranzicionale;
  3) drejtësia pa strategji mund t'i rrënojë proceset e drejtësisë tranzicionale; dhe
  4) qasjet diskutuese dhe të përqendruara nga viktimat për t'u marrë me të kaluarën dhe infrastruktura institucionale mund të jenë çelësi për tejkalimin e bllokadave ndaj të vërtetës dhe drejtësisë.

Hyrje

Trajtimi i së kaluarës (TsK) është njëri nga segmentet më sfiduese por më të rëndësishme të transformimit të konfliktit dhe ndërtimit të paqes në shoqëritë e prekura nga konflikti. Konfliktet e dhunshme jo vetëm rezultojnë me humbje njerëzore dhe shkatërrim fizik, por edhe e ngarkojnë dukshëm strukturën politike dhe sociale të shoqërisë. Kjo rezulton me ankesa të thella dhe ndjenjë mbizotëruese të padrejtësisë. Për të bërë tutje, shoqëritë duhet të përballen me të kaluarën, përkatësisht të përfshihen në forma dhe mënyra të ndryshme për të kujtuar dhe njohur padrejtësitë e kaluara, duke ofruar një masë drejtësie për viktimat dhe të mbijetuarit dhe të gjitha komunitetet e tjera të prekura përmes drejtësisë ndëshkuese dhe restauruese, si dhe duke ofruar garanci se padrejtësitë e kaluara nuk do të përsëriten përmes reformave strukturore dhe institucionale.[1] Megjithatë, trajtimi i së kaluarës mbetet njëri nga aspektet më komplekse të rindërtimit pas konfliktit. Ndër shumë përparësi të tjera konkurruese, si trajtimi i urgjencave humanitare, vendosja e rendit dhe ligjit, si dhe ndërtimi i institucioneve funksionuese dhe i shërbimeve publike, trajtimi i së kaluarës shpesh anashkalohet. Me angazhimin e pamjaftueshëm politik midis liderëve politikë kombëtarë, nismat për TsK shpesh përfundojnë duke u përdorur nga qeveritë kombëtare për agjendat e tyre politike dhe shpesh ato shtyten nga donatorë të jashtëm dhe zbatohen përmes organizatave joqeveritare (OJQ) me njëfarë përfshirjeje të komuniteteve të prekura.

Si rrjedhojë e kësaj, masat e drejtësisë tranzicionale kritikohen gjithnjë e më shumë meqë kuptohen dhe zbatohen si shabllon a kuti veglash, pra një grup i ngushtë masash për t'u zbatuar njëtrajtshëm kudo që ka pasur shkelje të përhapura të të drejtave të njeriut, pa i marrë parasysh shumë kontekstet lokale dhe viktimat e të mbijetuarit e konfliktit.[2] Më e rëndësishmja, nismat e TsK shpesh ngrihen në izolim relativ nga njëra-tjetra, pa ndonjë strategji gjithëpërfshirëse që të sigurojë ndikim pozitiv shoqëror në gjithë vendin. Një qasje gjithëpërfshirëse ndaj TsK kërkon strategji koherente në të cilën secili element i strategjisë pranon nevojën për nisma të tjera, dhe siguron hapësirën për to.[3] Një konsultim i kujdesshëm do të sigurohej që të prekurit nga konflikti të dëgjohen, ashtu që programet e drejtësisë tranzicionale të pasqyrojnë më së miri përvojat, nevojat dhe të drejtat e tyre aktuale. Siç pati deklaruar ish-Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Kofi Annan, më 2004: «përvojat më të suksesshme të drejtësisë tranzicionale ia detyrojnë një pjesë të madhe të suksesit cilësisë dhe sasisë së konsultimeve të kryera publikisht dhe me viktimat.»[4] Por, në praktikë, pjesëmarrja kuptimplote e komuniteteve të prekura në hartimin dhe zbatimin e nismave të TsK nuk është marrë

1. Për një diskutim të thelluar akademik dhe politik, shih: Ruti G. Teitel, Transitional Justice. Oxford: Oxford University Press, 2002; Colleen Murphy, The Conceptual Foundations of Transitional Justice, Cambridge: Cambridge University Press, 2017; Olivera Simic, An Introduction to Transitional Justice, London: Routledge, 2016; and UN Secretary-General, The Rule of Law and Transitional Justice in Conflict and Post-Conflict Societies, UN Doc. S/2004/616, 23 gusht 2004.
2. Roger Duthie dhe Paul Seils, "Justice Mosaics. How Context Shapes Transitional Justice in Fractured Societies". New York: International Centre for Transitional Justice, 2017.
3. OHCHR, "Rule-of law tools for post-conflict states: National consultations on transitional justice". New York dhe Gjenevë, 2009. Gjendet në: https://www.ohchr.org/Documents/Publications/NationalConsultationsTJ_EN.pdf.
4. UN Secretary-General, The Rule of Law and Transitional Justice in Conflict and Post-Conflict Societies, UN Doc. S/2004/616, 23 gusht 2004.

seriozisht nga autoritetet ndërkombëtare e as ato kombëtare.[5]

Që nga viti 1999, përpjekjet për trajtimin e të kaluarës dhe ndjekjen e drejtësisë tranzicionale në Kosovë kanë qenë jokonsistente dhe joadekuate. Krimet e luftës janë gjykuar nga gjykatat ndërkombëtare (ICTY), nga institucionet ndërkombëtare (UNMIK dhe EULEX) dhe gjykatat kombëtare. Përqendrimi në gjykimet e krimeve të luftës shpërfilli rëndësinë e kërkimit dhe dokumentimit të të vërtetës, aspekteve të përkujtimit, si dhe rëndësinë e dëmshpërblimeve dhe të kompensimeve. Me mungesë të këtyre elementeve, edhe njohja për të gjitha viktimat dhe të mbijetuarit e konfliktit (komuniteteve të prekura) u la pas dore. Iniciativat dhe mekanizmat institucionalë jo të bashkërenduar nuk ishin në gjendje të ofronin garanci për mospërsëritje dhe të ndërmerrnin reforma institucionale efektive, ose investime në mjete për avancimin e bashkëjetesës dhe të pajtimit. Grupi Punues Ndërministror i vitit 2012 për Trajtimin e të Kaluarës dhe Pajtimin (GPNM-TKP) përfundoi punën pa sukses në vitin 2016, pa nxjerrë një strategji kombëtare për drejtësinë tranzicionale, pasi puna iu pengua nga mungesa e zotimit dhe kapacitetit të mjaftueshëm politik vendor, dhe nga përfshirja e pamjaftueshme të komuniteteve të prekura. Themelimi më 2016 i Dhomave të Specializuara të Kosovës (DhSK) i ka kthyer çështjet e kohës së luftës në debatin publik dhe po ndikon negativisht në marrëdhëniet ndëretnike. Për më tej, një Komision i së Vërtetës dhe Pajtimit (KVP) është duke u përgatitur aktualisht, që sigurisht ka potencialin të ofrojë njohje më të gjerë të një dëshmimi të përbashkët historik nga komunitetet e ndryshme dhe potencialisht të kontribuojë për pajtim. Megjithatë, DhSK dhe përpjekjet përgatitore për krijimin e një KVP funksionojnë krejt të ndara nga njëra-tjetra në të njëjtin kontekst sfidues me ndikim potencialisht negativ shoqëror. Përveç strukturave dhe mekanizmave qeveritarë, disa organizata të shoqërisë civile (OShC) në Kosovë kanë punuar shumë vjet me çështje që lidhen me TsK përmes nismave të bazuara në projekte për drejtësinë restauruese, dokumentimin dhe monitorimin e gjyqeve për krime lufte, mbështetjen psiko-sociale për komunitetet e prekura, personat e zhdukur, përkujtimin gjithëpërfshirës dhe rrëfimet.

Përkundër të gjitha këtyre nismave, Kosova ende rropatet me trajtimin e të kaluarës së luftës; ekzistojnë disa të vërteta 'ekskluzive' që u pamundësojnë njerëzve t'i besojnë njëri-tjetrit, ka mungesë informacioni për shumë ngjarje të kohës së luftës ose për vendndodhjen e të zhdukurve, si dhe ende ka njëfarë sistemi të mosndëshkueshmërisë për krime (lufte) a korrupsion. Çka shpjegon mungesën e një qasjeje të integruar ndaj TsK në Kosovë? A kanë arritur nismat dhe institucionet ekzistuese t'u përgjigjen seriozisht nevojave të ndryshme të qytetarëve në kontekstin aktual? Cilat janë perspektivat për zhvillimin e një kornize strategjike të integruar, gjithëpërfshirëse dhe diskutuese dhe një infrastrukture institucionale për TsK në Kosovë? Ky studim synon të hedhë dritë në këto pyetje duke analizuar nismat dhe mekanizmat paraprakë të TsK në Kosovë si dhe shkallën në të cilën kanë qenë gjithëpërfshirëse ndaj komuniteteve të prekura, por edhe të eksplorojë një rrugëdalje e zgjidhje të mundshme për t'i kapërcyer të metat ekzistuese.

Gjejmë se njëzet e një vjet pas përfundimit të konfliktit të dhunshëm, Kosova nuk ka arritur të hartojë një strategji kombëtare për drejtësinë tranzicionale për shkak të mungesës së vullnetit politik dhe të aftësive midis të gjitha palëve të interesuara për t'u përfshirë mirëfilli me trashëgiminë e të kaluarës. Ajo që vijoi ishin nismat krah për krah nga institucionet shtetërore dhe organizatat joqeveritare (OJQ) që kanë qenë kryesisht nisma nga lart-poshtë dhe të bazuara në projekte, pa bashkërendim të mjaftueshëm dhe përfshirje të komuniteteve të prekura. Këto nisma karakterizohen nga: 1) interesimi i pamjaftueshëm nga ana e bashkësisë ndërkombëtare për t'i përfshirë çështjet e drejtësisë tranzicionale në thelbin e bisedimeve për paqe dhe dialog; 2) përpjekjet jo të plota, të politizuara dhe të personalizuara nga liderët politikë kombëtarë; ndërhyrjet afatshkurtra nga OJQ-të me depërtim dhe përfshirje të kufizuar të komuniteteve të prekura; 3) njohuri të pamjaftueshme për punën dhe ndikimin e nismave ekzistuese; dhe më e rëndësishmja 4) kanë anashkaluar rëndësinë e qasjeve të TsK nga poshtë-lart dhe me fokus tek viktimat. Si rrjedhojë e këtyre nismave paralele, të copëzuara dhe shpesh të mbivendosura, tani rrezikojmë të anashkalojmë aspekte të rëndësishme të kohës së luftës dhe padashtazi të promovojmë një kulturë të pandëshkueshmërisë, të injorancës dhe të mosnjohjes, duke dëmtuar kështu komunitetet e prekura dhe duke rrënuar në planin afatgjatë paqen e pajtimin e qëndrueshëm në Kosovë.

Për t'i korrigjuar këto të meta, ne pohojmë se Kosovës i duhet një infrastrukturë e integruar dhe diskutuese për drejtësinë tranzicionale, që promovon legjitimitetin demokratik dhe efikasitetin e përpjekjeve për TsK në Kosovë. Në këtë kontekst, koncepti i shqyrtimit përfshin procese të vendimmarrjes mbi TsK, bazuar në diskutimin demokratik, konsultimin e gjerë dhe përfshirjen e komuniteteve të prekura. Duke u mbështetur në informatat e dhëna nga të anketuarit dhe analizat krahasuese nga vendet e tjera, parashikojmë se demokratizimi i përpjekjeve për TsK në Kosovë duhet të kalojë në katër faza. Së pari, propozojmë që Kosova të krijojë një mirëkuptim kombëtar të informuar nga qytetarët mbi parimet dhe etikën për TsK në Kosovë. Këto parime dhe kjo etikë duhet të udhëheqin punën e të gjitha palëve të interesuara kombëtare dhe ndërkombëtare që punojnë me TsK në Kosovë. Ato duhet të promovojnë të drejtat, nevojat dhe interesat e komuniteteve të prekura; të sigurojnë ekuilibrin gjinor; dhe të promovojnë de-etnizimin, depolitizimin dhe depersonalizimin e nismave të TsK. Së dyti, propozojmë krijimin e një baze të integruar të njohurive dhe të depozitimit të strategjive, iniciativave dhe mekanizmave ekzistues specifikë për sektorin, për të siguruar transparencë, për të mundësuar dialog dhe për të promovuar vendimmarrjen e bazuar në prova. Së treti, propozojmë zhvillimin e një strategjie kombëtare për TsK, e cila informohet nga diskutimet me qytetarë dhe pjesëmarrje të komuniteteve të prekura, për të siguruar legjitimitetin demokratik dhe saktësinë e veprimeve për TsK. Në fund, për të siguruar që të implementohen kuptimi kombëtar, shpërndarja e njohurive dhe korniza strategjike, duhet të ekzistojë një infrastrukturë institucionale e integruar, përgjegjëse për t'i mbështetur nismat ekzistuese dhe të ardhshme për TsK në Kosovë.

Qasja jonë, e propozuar për të hartuar një infrastrukturë diskutuese për TsK në Kosovë, përmban elemente të rëndësishme dhe përcakton në një kornizë kohezive përpjekjen e kërkuar të ardhshme për adresimin e trashëgimive të pazgjidhura të konfliktit në Kosovë. Sidoqoftë, në fund varet nga palët përkatëse qeveritare dhe joqeveritare, përfshirë këtu komunitetet e prekura, që të marrin drejtimin për realizimin e saj në praktikë. Sigurisht, konteksti politik në Kosovë për momentin – pasiguria dhe paqëndrueshmëria që rrethojnë riorganizimin e qeverisë në fillimvitin 2020 – mund të mos jetë e favorshme për t'i dhënë përparësi TsK-së. Por, vizioni i propozuar këtu përmban gamë të mjaftueshme për drejtësi tranzicionale, duke i bashkuar pjesët që të ndërtojë një infrastrukturë solide për TsK në Kosovë.

Ky studim vijon si më poshtë. Pas kësaj hyrjeje dhe prezantimit të qasjes metodologjike, seksioni i parë shqyrton nismat kryesore të drejtësisë tranzicionale në Kosovë me qëllim që t'i hetojë veçoritë e tyre themelore dhe t'i eksplorojë të arriturat dhe mangësitë e tyre. Seksioni i dytë përshkruan një propozim për një infrastrukturë diskutuese për TsK në Kosovë, e cila përbëhet nga katër hapa kryesorë, të pasuar nga një përpunim i bazueshmërisë krahasuese dhe kufizimeve të mundshme. Në fund, studimi përfundon me katër reflektime nga Kosova, që mund të shërbejnë si mësime për mjediset e tjera të prekura nga konflikti.

5. Rosalind Shaw dhe Lars Waldrof, With Pierre Hazan, Localizing Transitional Justice : Interventions and Priorities after Mass Violence, Redwood City, CA: Stanford University Press, 2010.

Metodologjia dhe të dhënat

Ky studim shqyrton përpjekjet dhe nismat ekzistuese për trajtimin e së kaluarës dhe kërkimin e drejtësisë tranzicionale në Kosovë, si dhe eksploron shtigjet e mundshme për përmirësimin e ardhshëm të proceseve të drejtësisë tranzicionale.

Për arritjen e qëllimit të parë, studimi ofron një pasqyrë përshkruese të suksesit dhe të mangësive të proceseve të kaluara të drejtësisë tranzicionale në Kosovë. Për shqyrtimin e mekanizmave dhe nismave të kaluara, studimi ka shikuar politikat zyrtare dhe dokumentet ligjore, si dhe ka përdorur një gamë të gjerë raportesh e studimesh që vlerësojnë performancën dhe ndikimin e proceseve të drejtësisë tranzicionale në Kosovë. Për eksplorimin e perspektivave për zhvillimin e një shtegu të ardhshëm për drejtësinë tranzicionale në Kosovë, studimi mbështetet në informacionin e mbledhur për të, që përfshinte 22 intervista me palë qeveritare dhe joqeveritare dhe dy diskutime të grupeve të fokusit me qytetarë shqiptarë dhe serbë të Kosovës, të kryera gjatë muajit mars dhe prill 2020.

Fillimisht kemi parashikuar pesë diskutime në grupe fokusi, por pasi u përhap pandemia (Covid-19) dhe pasoi karantinimi në Kosovë, nuk ishim në gjendje t'i përfundonim ato. Intervistat dhe dëshmitë prej grupeve të fokusit nuk janë përdorë vetëm për të eksploruar sugjerimet e të anketuarve për hartimin e proceseve të drejtësisë tranzicionale në të ardhmen në Kosovë, por edhe për të rieksploruar perceptimin e tyre lidhur me përpjekjet e të kaluarës. Duke hedhur dritë për shtigjet e ardhshme dhe reflektimet përtej Kosovës, studimi merr qëndrim normativ, bazuar në provat empirike dhe krahasuese se si duhet të hartojë Kosova një infrastrukturë të ardhshme për t'u marrë me të kaluarën. Në fund, gjetjet e këtij studimi u ndanë dhe u diskutuan me një grup organizatash të shoqërisë civile që punojnë kryesisht në fushën e drejtësisë tranzicionale, të drejtave të njeriut dhe ndërtimit të paqes. Kjo siguroi vërtetimin e gjetjeve dhe ekzaminimin e qëndrueshmërisë së ideve të propozuara.

Drejtësia pa Strategji:

Pasqyrë e nismave për trajtim të së kaluarës në Kosovë (1999-2020)

Konflikti i dhunshëm i viteve 1998-1999 në Kosovë rezultoi me 13.535 viktima (civilë dhe të uniformuar), prej të cilëve 10.812 ishin shqiptarë (80%), 2,197 ishin serbë (16%), dhe 526 ishin romë, boshnjakë dhe anëtarë të komuniteteve të tjera pakicë (4%).[6] Midis tyre, 10.317 ishin vdekje të civilëve ose persona të zhdukur, nga të cilët 8.676 ishin shqiptarë, 1.196 serbë dhe 445 romë e të tjerë.[7] Vlerësohet se nga 3.218 viktima në mesin e formacioneve të armatosura, 2.131 ishin anëtarë të UÇK-së dhe të Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës (FARK), ndërsa 1.084 pjesëtarë të forcave ushtarake, paramilitare dhe policore serbe, si dhe 3 anëtarë të Forcës së NATO-s në Kosovë (KFOR; forca paqeruajtëse ndërkombëtare e udhëhequr nga NATO në Kosovë). Në mesin e viktimave, 1644 janë ende të pagjetur (deri në maj 2020).[8] Vdekja e dhunshme e viktimave civile përbën krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, të cilat ndalohen me ligj penal ndërkombëtar, ligj humanitar ndërkombëtar dhe ligj të konfliktit të armatosur. Përveç viktimave, konflikti ka pasur pasoja shkatërruese për aspektin material dhe fizik, si dhe politik, ekonomik dhe psiko-social të shoqërisë kosovare.

Këto trashëgimi të konfliktit vazhdojnë të ushqejnë perceptimin se pa i sjellë autorët e krimeve para drejtësisë, duke ditur se çka ka ndodhë, dhe pa u ofruar mbështetje të prekurve nga konflikti, shoqëria nuk do të jetë në gjendje të pajtohet me të kaluarën e dhunshme dhe të vazhdojë për të ndërtuar një paqe të qëndrueshme. Që nga përfundimi i konfliktit, marrja me të kaluarën dhe ndjekja e drejtësisë tranzicionale ka qenë proces i shkapërderdhur, të cilit i ka munguar një vizion strategjik, përfshirja e mirëfilltë e komuniteteve të prekura dhe qëndrueshmëria institucionale. Ajo që ndodhi në Kosovë gjatë njëzet e një vjetëve të fundit mund të përshkruhet më së miri si akumulim i nismave dhe mekanizmave paralelë, të mbivendosura dhe të krahasvëna, të cilët kanë qenë të shkurtër dhe të kontestuar gjerësisht. Ky seksion shqyrton nismat dhe mekanizmat kryesorë

6. Fondi për të Drejtën Humanitare (HLC), 'Libri i Kujtimit i Kosovës', Prishtinë 2011. Gjendet në: http://www.kosovomemorybook.org.
7. HLC, 'Libri i Kujtimit i Kosovës'.
8. Po aty. Nuk ka të dhëna të disponueshme dhe të qasshme për statusin e personave të zhdukur, pra nëse ishin civilë ose persona të armatosur në kohën e rrëmbimit ose zhdukjes. Ligji i Personave të Zhdukur nuk bën diskriminim ose diferencim të qartë të statusit të personave të zhdukur gjatë kohës së luftës.

Gjykatat ndërkombëtare dhe hibride për krimet e luftës në Kosovë

Vendosja e Kosovës nën administrimin ndërkombëtar dhe dështimi i një zgjidhjeje paqësore mes Serbisë dhe Kosovës rezultoi në vendosjen e mekanizmave të ndryshëm të drejtësisë tranzicionale nga jashtë pa një kornizë konsensuale dhe gjithëpërfshirëse për TsK. Përpjekja e parë për të promovuar drejtësinë tranzicionale në ish-Jugosllavi, përfshirë Kosovën, ishte Gjykata Ndërkombëtare e OKB për Krime Lufte në ish-Jugosllavi (ICTY). ICTY përqendroi strategjinë e vet prokuroriale në "udhëheqësit civilë, policorë dhe ushtarakë të nivelit të lartë, të cilësdo palë në konflikt që mund të mbahet përgjegjës për krimet e kryera gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë".[9] Midis viteve 1999 dhe 2017, ICTY paditi dhe gjykoi një numër të vogël të zyrtarëve të lartë ushtarakë dhe politikë serbë për krime lufte në Kosovë, përfshirë një ish-president, një kryeministër dhe ministra, si dhe udhëheqësinë kryesore ushtarake, të sigurisë dhe të inteligjencës. Lidhur me shqiptarët e Kosovës, ICTY gjykoi veçmas dy komandantë rajonalë të UÇK-së, Ramush Haradinajn dhe Fatmir Limajn (me bashkëpunëtorët e tyre); ku të dy u liruan pas gjykimeve të gjata. Sidoqoftë, Haradin Bala dhe Lah Brahimaj që ishin bashkëpunëtorë të Ramush Haradinajt, u shpallën fajtorë dhe u dënuan me 13 vjet, përkatësisht me gjashtë vjet burg. Ndërsa ICTY gëzon një njohje të gjerë për avancimin e drejtësisë penale ndërkombëtare, trashëgimia e vet në Ballkanin Perëndimor mbetet e diskutueshme, sepse bashkësitë etnike mbeten të polarizuara, viktimat janë të pakënaqura dhe shumë keqbërës mbeten të pandjekur penalisht.[10] ICTY është kritikuar kryesisht për gjykime të zgjatura, ankesa dhe rigjykime, bashkëpunim të kufizuar me autoritetet shtetërore, problemet me mbrojtjen e dëshmitarëve dhe vështirësitë në mbajtjen e të akuzuarve në paraburgim.[11]

Paralelisht me ICTY, Misioni i Administrimit të Përkohshëm të OKB në Kosovë (UNMIK) udhëhoqi hetimet dhe gjykimet e veta për krime lufte në Kosovë.[12] Deri në vitin 2004, gjykimet e UNMIK-ut për krime lufte mbështeteshin në legjislacionin e mëparshëm jugosllav, derisa ai t'i hartonte ligjet penale të veta për Kosovën. Sidoqoftë, UNMIK ka përjetuar dështime sistematike për gjykimin e rasteve të krimit të luftës në Kosovë, të dukshme nga vonesat me trajtimin e lëndëve, mungesa e vazhdimësisë brenda personelit gjyqësor, mungesa e trajnimit dhe aftësive për t'u marrë me rastet e krimeve të luftës, si dhe mbrojtja e pamjaftueshme e dëshmitarëve dhe gjyqtarëve.[13] Midis viteve 2000 dhe 2008, prokurorët e UNMIK-ut ngritën vetëm 10 raste në të cilat 19 shqiptarë, tre serbë dhe një malazez u akuzuan për krime lufte.[14] Kjo paaftësi për të ndjekur një numër të madh të rasteve të dyshuara dhe të të dyshuarve ka rrënuar besueshmërinë e UNMIK-ut në Kosovë.[15] Një i anketuar gjithashtu ngriti shqetësime në lidhje me dëshmitë e munguara mbi dhunën seksuale gjatë konfliktit të cilat ishin humbur në arkivat e UNMIK-ut.[16] Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, UNMIK rikonfiguroi dhe zvogëloi mandatin, si dhe i dorëzoi Misionit të BE-së të sapoformuar për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) informacion në lidhje me një numër të përgjithshëm prej 1.187 aktesh të dyshuara për krime lufte, përfshirë 50 raste shtesë që ishin gati për aktakuzë.[17] Midis viteve 2009 dhe 2018, prokurorët e EULEX-it kanë ngritur 22 raste në të cilat 39 shqiptarë, 11 serbë, një malazez dhe një nga komunitetet rom, ashkali e egjiptian, u paditën për krime lufte.[18] Në shumicën e rasteve, EULEX-i ishte pjesë e një trupi gjykues hibrid vendor, të përbërë nga gjyqtarë vendas dhe evropianë, që u mbështetën nga prokurorët ndërkombëtarë dhe policia e Zyra e Prokurorisë Speciale e Kosovës (ZPSK).[19] Megjithëse i perceptuar si më efektiv se UNMIK, edhe EULEX-i kritikohet për procedime të gjata dhe mosndërmarrje të masave efektive për mbrojtjen e dëshmitarëve.[20] Megjithatë, krahasuar me UNMIK-un, EULEX-i ka mbështetur autoritetet e Kosovës që të krijojnë një departament të krimeve të luftës brenda Zyrës së Prokurorisë Speciale, i cili ende drejtohet nga EULEX. Ngjashëm, Policia e Kosovës ka ngritur një njësi të hetimit të krimeve të luftës.

Që prej vitit 2018, Zyra e Prokurorisë Speciale e Kosovës (ZPSK) ka marrë një rol aktiv në hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të ligjit humanitar dhe të ligjit penal ndërkombëtar. Strategjia e vitit 2019 e Krimeve të Luftës që drejton punën e ZPSK kërkon të sigurojë një angazhim më të madh të autoriteteve të Kosovës në hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës. Ndërsa synon të forcojë bashkërendimin dhe bashkëpunimin me të gjitha institucionet e tjera përkatëse në Kosovë, ZPSK operon ndaras nga Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit Special (DhSK), të cilat funksionojnë sipas ligjit të Kosovës, por ndodhen në Holandë. Sidoqoftë, puna e institucioneve gjyqësore të Kosovës pengohet nga mungesa e kapaciteteve dhe burimeve për të hetuar dhe ndjekur penalisht një numër të madh të rasteve të krimeve të luftës. Puna e gjykatave të Kosovës është rrënuar edhe për shkak të mungesës së qasjes në provat materiale të krimeve të luftës, të mbledhura më parë nga ICTY ose organizata të tjera. Ndërsa EULEX-i ka transferuar te autoritetet e Kosovës rreth 900 raste të krimeve të luftës dhe 200 raste të personave të zhdukur, provat e ofruara kanë qenë të pamjaftueshme për të dëshmuar përgjegjësinë penale, duke rezultuar me pushimin ose përfundimin e hetimeve të shumta.[21] Megjithatë, ka shembuj pozitivë. Për shembull, si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë të QRVT me Zyrën e Prokurorisë Speciale dhe Policinë e Kosovës, dy serbë të Kosovës u akuzuan kohët e fundit për dhunë seksuale gjatë konfliktit.[22] Pavarësisht kësaj, ka shqetësime edhe për aftësinë e gjyqësorit dhe policisë së Kosovës për të trajtuar rastet e krimeve të luftës, përfshirë

9. ICTY, Deklaratë e Carla Del Ponte, 'Prokurore e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë për Hetimin dhe Procedimin e Krimeve të Kryera në Kosovë'. Hagë, 29 shtator 1999.
10. Për një diskutim skolastik dhe kritik shiko: Janine N. Clark, International Trials and Reconciliation: Assessing the Impact of the International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia. London: Routledge, 2014.
11. ICTY, 'Report of the President on the Conference, Assessing the Legacy of the ICTY', The Hague, 27 prill 2010. Gjendet në: http://www.icty.org/x/file/Press/Events/100427_legacyconference_pdt_report.pdf
12. Për një diskutim përkatës shih: Aaron Fichtelberg, Hybrid Tribunals: A Comparative Examination, New York: Springer, 2015.
13. OSCE, 'Kosovo's War Crimes Trials: An Assessment Ten Years On (1999–2009). Prishtinë, maj 2010, f. 6. Gjendet në: http://www.osce.org/kosovo/68569?download=true.
14. HLC, 'An Overview of War Crime Trials in Kosovo in the Period 1999-2018', Pristhinë, tetor 2018, f.412,
15. Fokus Grupi 1, 06 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.
16. Intervista U. 27.05.2020. Prishtinë, Kosovë. Shih edhe: Amnesty International. Kosovo: UNMIK's legacy: The failure to deliver justice and reparation to the relatives of the abducted', pf 10. 2013. Londër, MB. Gjendet në: https://www.amnesty.org/download/Documents/16000/eur700092013en.pdf.
17. UN Security Council, 'Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo', UN Doc. S/2009/149, 17 mars 2009, para. 19.
18. HLC, 'An Overview of War Crime Trials in Kosovo in the Period 1999-2018', Pristhinë, tetor 2018, f.412, Gjendet në: https://www.hlc-kosovo.org/wp-content/uploads/2018/10/HLC-Kosovo-An-overview-of-war-crime-trials-in-Kosovo-1999-2018.pdf .
19. Kuvendi i Kosovës, 'Ligji Nr. 05 / L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar', Prishtinë, 3 gusht 2015. Gjendet në: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/03-L-052%20a.pdf.
20. Amnesty International, 'Kosovo: Time for EULEX to Prioritize War Crimes', United Kingdom, 2012, f.4. Gjendet në: https://www.amnesty.eu/wp-content/uploads/2018/10/260412_EULEX_Report.pdf.;
21. Prokuroria Speciale e Kosovës, 'Strategjia e Krimeve të Luftës', Prishtinë, shkurt 2019, f. 5. Gjendet në: http://www.kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/Statistika%20dai%20Raporte / Strategjia%20e% 20Komunikimit / Strategjia%20e% 20Krimeve% 20T% C3% AB% 20Luft% C3% QA / STRATEGJIA% 20QF% 20WAR% 20CRIMES.pdf.
22. Kontribut me shkrim nga QRVT, 26 maj 2020.

numrin e pamjaftueshëm të prokurorëve. Për më tej, mungesa e bashkëpunimit gjyqësor me Serbinë, ku banojnë shumica e kriminelëve të dyshuar të luftës, vazhdon të pengojë aftësinë për të hetuar dhe gjykuar raste të krimeve të luftës.[23] Rrjedhimisht, e vetmja mënyrë se si mund të ndiqen të dyshuarit në gjithë juridiksionin është përmes urdhërarresteve ndërkombëtare që kërkojnë që pala e dyshuar të largohet nga vendi i vet i juridiksionit. Për më tej, ka shqetësime të konsiderueshme për gatishmërinë e gjykatave të Kosovës për të hetuar, ndjekur penalisht dhe gjykuar rastet e krimeve të luftës që përfshijnë ish-pjesëtarët e UÇK-së, të shkaktuara nga konteksti shoqëror dhe politik i luhatshëm në Kosovë. Këto pengesa kanë çuar në sasi të madhe dosjesh të pakompletuara të rasteve të krimit të luftës që pengojnë qasjen e viktimave në drejtësi.

Që nga viti 2019, gjykatat e Kosovës kanë mundësinë të kryejnë gjykime në mungesë me qëllim luftimin e pandëshkueshmërisë së krimeve të kryera në territorin e Kosovës, sidomos të rasteve të individëve që nuk janë në territorin e Kosovës.[24] Kjo në veçanti u mundëson gjykatave të procedojnë me aktakuza për krime të kryera nga individë që aktualisht banojnë në Serbi, por nuk mund të ekstradohen për shkak të refuzimit të autoriteteve serbe dhe mungesës së bashkëpunimit juridik midis dy vendeve. Sidoqoftë, gjykimet në mungesë nuk janë zhvilluar ende mbasi Ministria e Drejtësisë e Kosovës po kërkon qartësi nga Komisioni i Venecias[25] nëse ky lloj i gjykimeve duhet të shtrihet edhe në rastet e krimeve jo të luftës dhe në periudhën e pasluftës.[26] Gjykimet në mungesë nuk shihen nga të gjithë si kontribut për drejtësinë, pasi shihen si "të njëanshme dhe nuk ndihmojnë në shërimin e viktimave, sepse thjesht zvarriten në gjykata, por ato zhgënjehen dhe frustrohen sepse kriminelët nuk dërgohen prapa grilave".[27] Ndërsa gjykatat e Kosovës kanë paditur dhe dënuar një numër të kufizuar të dyshuarish për krime lufte, ka pasur vijime dhe angazhime të pamjaftueshme me familjet e viktimave dhe të të mbijetuarve të atyre krimeve.[28] Ndonëse një grusht OJQ-sh vendase dhe mediash kanë monitoruar punën e gjykatave, ka mungesë komunikimi dhe përafrimi të institucioneve gjyqësore me komunitetet e prekura. Pavarësisht këtyre, është sinjal pozitiv se strategjia e ZPSK për krime lufte synon të «rrisë nivelin e vetëdijesimit publik mbi nevojën për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të ligjit ndërkombëtar humanitar».[29]

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK) përfaqësojnë përpjekjen e fundit të bashkësisë ndërkombëtare për të adresuar një varg krimesh të pretenduara të luftës që mbeten shumë të kontestuara në Kosovë. Dhomat e Specializuara u krijuan më 2015 nën ligjin e Kosovës për të hetuar dhe gjykuar krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe krimet e tjera të supozuara në një raport të lëshuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (APKE) të publikuar më 7 janar 2011 (i njohur si Raporti Marty). Raporti Marty ngriti dy pohime të gjera për shkelje penale të paadresuara. E para ka të bëjë me zhdukjet, ndalimet dhe vrasjet e pakicave etnike dhe të kundërshtarëve politikë shqiptarë në Kosovë.[30] Pretendimi i dytë lidhet me vrasjet e kryera për të lehtësuar vjeljen dhe trafikimin e organeve njerëzore. Reagimi negativ ndaj Raportit Marty në Kosovë, shoqëruar me kapacitetin e dobët gjyqësor për të hetuar krimet e luftës dhe masat e pamjaftueshme për mbrojtjen e dëshmitarëve, e shtyu BE-në të krijojë më 2011 një Task Forcë Speciale Hetuese (TFSH) për të kryer një hetim të pavarur për pretendimet e krimeve të luftës dhe krimit të organizuar, të ngritura nga Raporti Marty. Gjetjet paraprake të TFSH përputheshin me shumicën e pretendimeve të ngritura në Raportin Marty, çka hapi rrugën për krijimin e Dhomave të Specialistëve në 2015. Mandati i Dhomave të Specializuara, të cilat ndodhen në Hagë ndërsa janë ende pjesë e sistemit juridik të Kosovës, ishte të siguronin «procedura penale të pavarura, të paanshme, të drejta dhe efikase lidhur me pretendimet për krime të rënda ndërkufitare dhe ndërkombëtare të kryera gjatë dhe fill pas konfliktit në Kosovë" që dalin nga Raporti Marty dhe TFSH.[31] Llojet e krimeve të luftës që Dhomat e Specializuara do t'i gjykojnë, përfshijnë: «vrasje; shfarosje; robërim; deportim; burgim; torturë; përdhunim, skllavëri seksuale, prostitucion i detyruar, shtatzëni e detyruar dhe çdo formë tjetër e dhunës seksuale; persekutim në baza politike, racore, etnike ose fetare; zhdukje me forcë e personave; si dhe akte të tjera çnjerëzore".[32]

Ndërsa Dhomat e Specializuara kanë potencialin për të pasur ndikim pozitiv shoqëror në Kosovë, duke ofruar një masë drejtësie për viktimat, ato janë kritikuar për njëanshmëri ndaj shqiptarëve të Kosovës, të fshehtë, të dëmshme për sovranitetin gjyqësor të Kosovës dhe si instrument gjeopolitik i kundërshtarëve të Kosovës.[33] Dhomat e specializuara u krijuan në një kohë kur arritjet e mekanizmave të mëparshëm të drejtësisë penale, ndërkombëtare e hibride, në Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor nuk ishin krejt të suksesshme për të sjellë drejtësi te viktimat dhe për t'i kontribuar pajtimit. Në dhjetor 2017, gjithsej 43 deputetë të Kuvendit të Kosovës filluan një iniciativë për revokimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.[34] Kjo iniciativë ngriti shqetësime serioze për angazhimin e liderëve politikë të Kosovës për të ndjekur dhe gjykuar krimet e lartpërmendura dhe për të respektuar detyrimet ndërkombëtare të lidhura me Kosovën. Edhe pse gjykata u krijua zyrtarisht në vitin 2016 dhe dëshmitarët gjithnjë e më shumë po thirren, ajo ende nuk ka lëshuar asnjë aktakuzë. Dhomave të Specializuara iu deshën pothuajse katër vjet që të bëhen funksionale dhe të fillojnë hetimet zyrtare. Që nga viti 2019, Zyra e Prokurorit të Specializuar intervistoi mbi njëqind të dyshuar dhe dëshmitarë të mundshëm, shumica e të cilëve ishin pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Vetëm në shkurt 2020, Presidenti i Dhomave të Specializuara shpalli një vendim për caktimin e një gjykatësi paraprak, çka tregon se raundi i parë i aktakuzave mund të zhvillohet në të ardhmen e afërt.[35] Sidoqoftë, detajet e aktakuzave të tilla mbeten tani për tani konfidenciale, derisa të shpallet publikisht një vendim për ndjekje penale.

Me kalimin e viteve, Njësia e Informimit dhe Komunikimit Publik e Dhomave të Specializuara ka realizuar takime të shumta këshilluese me palët e interesuara ndërkombëtare, grupet e zgjedhura të shoqërisë civile, komunitetet e ndryshme dhe mediat në Kosovë. Por, keqinformimi publik dhe

23. Intervista D. 05 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

24. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr 06/L-06 / L-091 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Procedurës Penale, Prishtinë, Kosovë, 04.07.2019. Gjendet në:https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20500.

25. Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit – i njohur më mirë si Komisioni i Venecias meqë mblidhet në Venecia – është organi këshillimor i Këshillit të Evropës për çështje kushtetuese: https://www.venice.coe.int/WebForms/pages/?p=01_Presentation&lang=EN.

26. Kosova Post, 'Interview with Minister Haxhiu', shkurt 2020. Gjendet në: https://kosovapost.net/per-kodin-e-ri-penal-kerkohet-opinion-i-komisionit-te-venedikut-flet-ministrja-haxhiu-video/.

27. Intervista G. 10 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

28. Po aty.

29. Prokuroria Speciale e Kosovës, 'Strategjia e Krimeve të Luftës', f. 7.

30. Parlamentary Assembly of the Council of Europe, 'Inhuman treatment of people and illicit trafficking in human organs in Kosovo', Doc. Nr 12462, 07 janar 2011. Gjendet në http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/X2H-Xref-ViewPDF.asp?FileID=12608&lang=en.

31. Kuvendi i Kosovës, 'Ligji Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar', Prishtinë, 3 gusht 2015.

32. Po aty, Neni 13.1

33. Fokus Grupi 1, 06 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

34. Komisioni Evropian 'Kosovo 2018 Report, 2018, f. 17. Gjendet në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-kosovo-report.pdf.

35. Kosovo Specialist Chambers, 'Decision Assigning a Pre-Trial Judge', 14 February 2020, Hagë, Holandë. Gjendet në: https://repository.scp-ks.org/details.php?doc_id=091ec6e980281f0e&doc_type=stl_filing&lang=eng.

mungesa e njohurive në lidhje me Dhomat e Specializuara mbetet i përhapur në Kosovë.[36] Ka njëfarë perceptimi të përgjithshëm se pa procedura të gjera të legjitimitetit, gjykimet e Dhomave të Specializuara nuk kanë gjasa të sjellin ndryshimin e dëshiruar shoqëror në Kosovë.[37] Shumica dërrmuese e shqiptarëve në Kosovë e konsiderojnë presionin nga aleatët ndërkombëtarë të Kosovës si arsyen kryesore se pse Kuvendi i Kosovës pranoi të themelojë Dhomat e Specializuara. Si mekanizëm i imponuar nga jashtë, Dhomat e Specializuara janë përballur me refuzim të fortë politik dhe shoqëror në Kosovë, të shoqëruar me kundër-narracione dhe fushata të fuqishme mediatike që kritikojnë hetimet, procedurat dhe aktgjykimet eventuale. Ka një perceptim të përhapur në Kosovë se mekanizmat e drejtësisë tranzicionale përdoren nga bashkësia ndërkombëtare për të sabotuar aktorët lokalë dhe për t'i detyruar t'i mbështesin politikat e imponuara nga jashtë. Në veçanti, mandati i ngushtë i Dhomave të Specializuara për të gjykuar vetëm krimet e pretenduara të UÇK-së shihet si drejtësi selektive dhe ka shumë gjasa që nuk do të kontribuojë në stabilitetin e brendshëm dhe normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.[38] Komuniteti serb në Kosovë është i ndarë kur është fjala për ndikimin e mundshëm të Dhomave të Specializuara. Shumica e tyre kanë frikë se nuk ka gjasa që Dhomat e Specializuara të sjellin drejtësi për ata që kanë kryer krime të rënda lufte.[39]

Shumica e të anketuarve në këtë studim kanë theksuar rëndësinë e gjykimeve për ofrimin e një mase drejtësie për viktimat e luftës dhe të mbijetuarit. Sidoqoftë, trashëgimia dhe ndikimi i gjykatave ndërkombëtare dhe hibride në Kosovë mbeten shumë të diskutueshme.[40] Nga të gjitha 48 rastet e krimeve të luftës, të paraqitura nga gjykatat e UNMIK-ut, EULEX-it dhe të Kosovës, vetëm 111 persona u akuzuan, nga të cilët 39 u dënuan dhe 38 të tjerë u liruan.[41] Nga ata, 61 ishin shqiptarë, 44 serbë, pesë malazezë dhe pesë nga komunitetet romë, ashkalinj dhe egjiptianë.[42] Gjykimet e krimeve të luftës kanë tendencë të polarizojnë më tej marrëdhëniet midis grupeve etnike në Kosovë. Gjykatat ndërkombëtare dhe hibride për krimet e luftës shihen nga të dy komunitetet, shqiptarët dhe serbët në Kosovë, si mekanizma për ta mbajtur palën tjetër përgjegjëse për veprime të gabuara, për të kultivuar një kulturë viktimizimi dhe për të zgjeruar fuqinë politike të forcave nacionaliste. Brenda secilës bashkësi etnike, ata që ndiqen penalisht për krime lufte perceptohen si heronj dhe gjykimet e anëtarëve të grupit janë shumë jopopullore, shpesh duke ndezur protesta publike. Megjithatë, glorifikimi i grupit ofron legjitimitet mbulesë pa dashje për disa nga të dënuarit e krimeve të luftës, të cilët njëkohësisht janë akuzuar për korrupsion ose keqpërdorim të detyrës publike.

36. Kosovo Specialist Chambers, 'Outreach Program', Hagë, 2020, f.7. Gjendet në: https://www.scp-ks.org/sites/default/files/public/content/outreach_programme-en.pdf.

37. Shih: Aidan Hehir, 'Lessons Learned? The Kosovo Specialist Chambers' Lack of Local Legitimacy and Its Implications', Human Rights Review Vol, 20, 2019, pp. 267–287.

38. Gëzim Visoka, Assessing the Potential Impact of the Kosovo Specialist Court, Utrecht and Hague, NL: PAX and Impunity Watch, 2017, f. 27. Gjendet në: https://www.paxforpeace.nl/publications/all-publications/assessing-the-potential-impact-of-the-kosovo-specialist-court.

39. Visoka, Assessing the Potential Impact of the Kosovo Specialist Court, f. 28. Shih edhe: Michael James Warren, Kushtrim Koliqi, Nenad Maksimović, Marlies Stappers, Public Perception of the Kosovo Specialist Court: Risks and Opportunities, CPT, Integra, Impunity Watch and PAX, Prishtinë, 2017. Gjendet në: https://www.paxforpeace.nl/publications/all-publications/public-perception-of-the-kosovo-specialist-court.

40. Anna Di Lellio dhe Caitlin McCurn, 'Engineering Grassroots Transitional Justice in the Balkans: The Case of Kosovo', East European Politics and Societies, Vol. 27, No. 1, 2013, f. 129-48.

41. HLC, An Overview of War Crime Trials in Kosovo in the Period 1999-2018', Prishtinë, tetor 2018, p. 413, Gjendet në: https://www.hlc-kosovo.org/wp-content/uploads/2018/10/HLC-Kosovo-An-overview-of-war-crime-trials-in-Kosovo-1999-2018.pdf.

42. HLC, 'An Overview of War Crime Trials in Kosovo in the Period 1999-2018', f. 411.

Nismat për kërkimin dhe dokumentimin e të vërtetës

Njohja e të vërtetës së asaj që ndodhi gjatë konfliktit të dhunshëm dhe çfarë trashëgimish la konflikti, janë thelbësore për të siguruar një mbyllje të të kaluarës dhe për të ecur tutje. Në Kosovë, shumica e punës fillestare të kërkimit të të vërtetës sillej rreth çështjes së personave të zhdukur. Gjithashtu, dokumentimi për shkeljet e të drejtave të njeriut është ndërmarrë nga grupet lokale të shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare. Ndonëse shumica e trupave të personave të zhdukur janë identifikuar, ende ka 1644 persona të zhdukur. Hedhja e dritës mbi fatin e personave të zhdukur duke gjetur, identifikuar dhe asgjësuar mbetjet mortore dhe mbledhur të dhëna në lidhje me këto mbetje, është pjesë e rëndësishme e përpjekjeve të kërkimit të të vërtetës dhe pajtimit eventual.[43] Sidoqoftë, hetimi për personat e zhdukur në Kosovë është kritikuar shumë për shkak të administratave të ndryshuara, raportimit dhe menaxhimit jokonsistent të rasteve, dhe mungesës së iniciativave për të ndjekur hetimet penale.[44] Shumica e personave të zhdukur në Kosovë janë gjetur në lokacione të ndryshme brenda Kosovës, ndërsa një numër i madh janë gjetur edhe në Serbi. Midis viteve 2002 dhe 2008, Zyra e UNMIK-ut për Personat e Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore (ZPZhML) dha informacione mbi fatin e personave të zhdukur në Kosovë. Megjithëse ZPZhML bëri përparim të mirë, siç është nënshkrimi i disa protokolleve me Serbinë për zhvarrosjen dhe riatdhesimin e mbetjeve të shqiptarëve të Kosovës nga territori serb, mungesa e informacionit për vendet e mundshme të varrimeve dhe mungesa e stafit dhe burimeve penguan shpejtësinë e zhvarrosjes dhe proceset e identifikimit. Në vitin 2006, ZPZhML u përfshi në Ministrinë e re të Drejtësisë dhe u krijuan dy organe kryesore për të nxitur pronësinë lokale mbi problemin e personave të zhdukur. Më parë, më 2004, u krijua një Grup Punues për Personat e Zhdukur për të shkëmbyer informacione me një grup të ngjashëm në Serbi për gjetjen e varreve të mundshme matanë kufijve dhe për të informuar familjet krahas. Sidoqoftë, është arritur përparim i kufizuar lidhur me shkëmbimin e informacionit, pjesërisht për shkak të mungesës së vullnetit real politik nga të dyja palët për t'u siguruar që të gjenden të gjithë personat e zhdukur.[45] Që nga viti 2011, Kosova ka një ligj të posaçëm për personat e zhdukur që synon të mbrojë të drejtat dhe interesat e personave të zhdukur dhe të familjarëve të tyre, të raportuar si të zhdukur gjatë periudhës nga 1 janari 1998 deri më 31 dhjetor 2000 si pasojë e konfliktit të dhunshëm në Kosovë gjatë viteve 1998-1999.[46] Në vitin 2019, një dokument koncept mbi personat e zhdukur u miratua nga Qeveria e Kosovës, që kërkon të rishikojë legjislacionin dhe mbështetjen institucionale për familjet e personave të zhdukur në Kosovë.[47]

Përkundër shumë sfidave, EULEX mori një rol kryesor në identifikimin e organeve dhe vendeve ku janë varrosë personat e zhdukur, dhe kur rrethanat lejuan, ai ndërmjetësoi ndihmën juridike të ndërsjellë midis autoriteteve kosovare dhe serbe.[48] Me gjithë përpjekjet e shumta diplomatike, autoritetet serbe kanë refuzuar të japin informacione rreth trupave të personave të zhdukur nga frika se ekspozimi i

43. Intervista D. 05 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

44. Hana Marku. 'The Road to Justice: Missing Persons in Kosovo from a Policy Standpoint', Center for Research Documentation and Publication, Prishtinë, 2012.

45. Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur, 'Missing Persons from Kosovo: Conflict and Aftermath', Prishtinë, Kosovë, 2017. Gjendet në: https://www.icmp.int/wp-content/uploads/2017/05/Kosovo-stocktaking-ENG.pdf).

46. Ligji i Kosovës për Personat e Zhdukur (Nr.03 / L-023) më 31 gusht 2011.

47. Zyra e Kryeministrit, Prishtinë, maj 2019. gjendet në: http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2019/07/Koncept-Dokumenti-per-Personat-e-Zhdukur-per-publikim.pdf.

48. Amnesty International, 'Burying the Past: 10 Years of Impunity for Enforced Disappearances and Abductions in Kosovo'. Raporti Nr. EUR 70/007/2009., Londër, 2009. Gjendet në: http://www.amnesty.org/en/documents/eur70/007/2009/en/.

të vërtetës do t'i dobësojë më tej pretendimet e tyre mbi Kosovën dhe do të rezultonte me ndjekjen penale të përgjegjësve për abuzime të tilla të të drejtave të njeriut të cilët lëvizin lirshëm në Serbi.[49] Në vitin 2008, Qeveria e Kosovës themeloi një Komision për Personat e Zhdukur së bashku me mekanizmat mbështetës të mjekësisë ligjore, që deri më tash kanë luajtur vetëm rol të kufizuar në identifikimin e trupave të personave të zhdukur dhe mbështetjen e familjeve të tyre.[50] Që nga viti 2008, Kuvendi i Kosovës ka themeluar një Komision të përcaktuar për të Drejtat e Njeriut, Barazinë Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticionet. Me gjithë krijimin e Këshillit Koordinues të Shoqatës së Familjeve të Personave të Zhdukur në Kosovë më 2011, shoqata të tilla ende mbeten të bëjnë një thirrje koherente për veprim. Për më tej shoqatat e familjarëve të komuniteteve serbe dhe shqiptare vazhdojnë të veprojnë ndaras nga njëra-tjetra, duke e copëzuar kauzën e tyre.[51] Një përjashtim për këtë është Qendra Burimore për Persona të Zhdukur (MPRC) që synon të «bashkojë familjet e personave të zhdukur nga të gjitha prejardhjet etnike, duke inkurajuar bashkëpunimin midis tyre me qëllim të shkëmbimit të njohurive drejt ndriçimit të fatit të personave të zhdukur në Kosovë».[52]

Në Kosovë, dokumentimi i krimeve të luftës dhe narrativat e komuniteteve të prekura janë të shpërndara. Që nga viti 2011, Qeveria e Kosovës themeloi Institutin për Kërkime të Krimeve të Luftës si një institucion të kërkimit publik që të funksionojë nën Ministrinë e Drejtësisë.[53] Qëllimi i Institutit ishte mbledhja, sistematizimi, përpunimi dhe publikimi i të dhënave për krimet kundër paqes, krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe aktet e gjenocidit të kryera në Kosovë në periudhën 1998 deri në qershor 1999. Sidoqoftë, Instituti nuk mundi të kontribuojë në dokumentimin dhe kërkimin e të vërtetës kryesisht për shkak të mbështetjes së kufizuar nga shteti, çka rezultoi në kapacitet, mjete dhe bashkërendim të dobët me aktorët e tjerë të drejtësisë tranzicionale në Kosovë, si dhe përfshirje të kufizuar të komuniteteve të prekura.[54] Si i tillë, Instituti luajti rol modest edhe në dokumentimin e krimeve të luftës në Kosovë dhe në publikimin e provave, që më së shumti përdoren për përkujtim në vend se hetim të atyre krimeve të dokumentuara. Raportohet se ka mbledhur rreth 12.000 dokumente për krimet e luftës.[55] Instituti funksionoi me një buxhet më të vogël se çerek milioni euro. Instituti nuk mori asnjëherë mbështetje nga donatorët ndërkombëtarë[56], dhe përfundimisht u mbyll në vitin 2018.

Shumica e të anketuarve, përfshirë ata të komuniteteve viktima dhe të mbijetuar, kanë njohur kontributin domethënës të organizatave të shoqërisë civile për adresimin e trashëgimisë së të kaluarës së dhunshme.[57] OShC-të në Kosovë dhe më gjerë në rajon kanë ndërmarrë një gamë të gjerë iniciativash të TsK, duke përfshirë përpjekjen për krijimin e një komisioni rajonal të të vërtetës, dhe përpjekjet kombëtare për t'i dokumentuar viktimat e konfliktit, për t'i monitoruar

49. Intervista D. 05 mars 2020, Prishtinë, Kosovë. Shih edhe: RIDEA, 'The Issue of Missing Persons in the Context of an Eventual 'Grand Finale' between Kosovo and Serbia', shtator 2019. Gjendet në: http://www.ridea-ks.org/Articles/3/Images/29-01-2019/433438_The_Issue_of_Missing_Persons_in_the_context_of_an_eventual_'Grand_Finale'_between_Kosovo_and_Serbia.pdf.

50. Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur, 'Missing Persons from Kosovo'.

51. Marku, 'The Road to Justice: Missing Persons in Kosovo from a Policy Standpoint'.

52. Histori Orale Kosova, Prishtinë 2019, Gjendet në: https://mprc-ks.org/about-us/; https://oralhistorykosovo.org/.

53. Zyra e Kryeministrit, Prishtinë, qershor 2011. Gjendet në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_mbledhjes_se_19-te_te_Qeverise_2011.pdf.

54. Drejtësia Tranzicionale e Ballkanit, 'Kosovo War Crimes Institute Accused of Inaction', Prishtinë, qershor 2014. Gjendet në: https://balkaninsight.com/2014/06/25/kosovo-war-crime-institute-lags-in-work-experts-say/.

55. Intervista T. 21 prill 2020, Prishtinë, Kosovë.

56. Po aty.

57. Intervista S. 01 Prill 2020, Prishtinë, Kosovë.

gjykimet e krimeve të luftës, për t'i mbështetur viktimat dhe për t'i identifikuar të zhdukurit dhe personat e pagjetur. Nisma më domethënëse rajonale ka qenë KOMRA, Komisioni Rajonal i ngarkuar me vendosjen e fakteve për të gjitha viktimat e krimeve të luftës dhe të shkeljeve të tjera të rënda të të drejtave të njeriut, të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë nga 1 janari 1991 deri më 31 dhjetor 2001. KOMRA parashikohej të ishte komision zyrtar ndërqeveritar që do të themelohej bashkërisht nga pasardhësit e ish-republikave jugosllave. Sidoqoftë, për shkak të një shumësie mosmarrëveshjesh politike të pazgjidhura midis vendeve të rajonit, KOMRA nuk u miratua nga qeveritë. Koalicioni për KOMRA, i udhëhequr nga një grup i OJQ-ve në rajon, u krijua që të lobojë për miratimin e Statutit të KOMRA-s nga qeveritë kombëtare në Ballkanin Perëndimor, dhe përpiloi një udhëzues të hollësishëm zbatimi dhe plan veprimi.[58] Ndërsa KOMRA si iniciativë ambicioze rajonale ende nuk është materializuar, ajo ka luajtur rol të madh në mbështetjen e projekteve të ndryshme të TsK dhe të drejtësisë tranzicionale, si dhe nismave në rajon.

Ndër nismat më domethënëse përfshihen 'Libri i Kujtimit i Kosovës' (LKK) i ndërmarrë nga Fondi për të Drejtën Humanitare (FDH) si përpjekja e parë dhe më serioze për të dokumentuar viktimat njerëzore gjatë luftës në Kosovë. Procesverbali bazohet në 31.600 dokumente dhe mbi 10.000 deklarata të dëshmitarëve, duke ofruar kështu një përmbledhje të saktë dhe të detajuar të të gjitha viktimave njerëzore, përfshirë detajet e tyre personale, një përmbledhje të shkurtër të jetës dhe vdekjes së tyre, si dhe referenca në burimet që dokumentojnë narracionin. Që nga fillimi i viteve 1990, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka luajtur rol të rëndësishëm në mbledhjen e dëshmive për abuzimet e të drejtave të njeriut dhe krimet e luftës të kryera në Kosovë, që u përdorën prej ICTY dhe gjykatave hibride të krimeve të luftës në Kosovë. Pastaj ekziston Qendra e Kosovës për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës (QKRVT), e cila ofron mbështetje psikologjike për të mbijetuarit dhe ndihmë të vlefshme për të kapërcyer dobësitë institucionale dhe mosbesimin e komuniteteve të prekura.[59] Ata janë angazhuar edhe në përpjekje avokimi për njohjen ligjore të të mbijetuarve të dhunës seksuale nga koha e luftës. Rrjeti i Grave të Kosovës lobon për të drejtat dhe interesat e grave në Kosovë, përfshirë ato të prekura nga dhuna seksuale gjatë konfliktit.[60] Organizata të tjera, si INTEGRA, Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (NRDNj), Forum ZFD, New Social Initiative, Kosovo 2.0, Rrjeti Ballkanik i Raportimit Hulumtues (BIRN) dhe Partnerët Kosova, kanë ndërmarrë projekte të ndryshme për të avokuar të drejtat dhe interesat e komuniteteve të prekura, promovuar kujtesën gjithëpërfshirëse dhe dokumentuar narrativat dhe përvojat e komuniteteve të prekura, si dhe për të punuar me të gjitha grupet etnike përmes aksioneve në rrugë, nismave artistike dhe arsimore, mediave dhe dialogut shoqëror.[61]

Ndërsa pranohet se grupet e shoqërisë civile në Kosovë kanë kontribuar ndjeshëm në dokumentimin dhe kërkimin e të vërtetës, disa të anketuar ngritën një varg shqetësimesh për punën e tyre. Një aktivist i shoqërisë civile kosovare pranoi se: «Shoqëria civile mund të ndihmojë

58. Shih: Koalicioni për KOMRA, Draft Statuti i KOMRA, 28 Tetor 2014. Gjendet në: http://recom.link/wp-content/uploads/2014/11/SR-Izmene-Statuta-FINAL-12.11.2014-ff.pdf. Shih edhe: Koalicioni për KOMRA, Udhëzuesi, maj 2018. Gjendet në: http://recom.link/wp-content/uploads/2018/06/RECOM-Roadmap-ff-1.pdf; dhe Koalicioni për KOMRA, Propozim për Planin e Veprimit për KOMRA, maj 2018. Gjendet në: http://recom.link/wp-content/uploads/2018/06/Annex-Action-Plan-ff.pdf.

59. Konsultim me grupin e shoqërisë civile në Kosovë, 20 maj 2020, online. Shih edhe: http://krct.org/.

60. Konsultim me grupin e shoqërisë civile në Kosovë, 20 maj 2020, online. Shih edhe: https://womensnetwork.org/.

61. Shih për shembull: Integra, 'Unë dua të dëgjohem', Prishtinë, 2009. Gjendet në: https://ngo-integra.org/publication/I%20Want%20to%20be% 20Heard% 20-% 20Memory% 20Book.pdf; Forum ZDF, 'Të jetosh me kujtimet e të zhdukurve', Prishtinë, 2019. Gjendet në: http://www.dwp-balkan.org/kcfinder/upload/files/LWMTM/Final%20ENG%20web.pdf. Këto OShC kanë përdorur edhe arkivat e ICTY që përmbajnë dokumente parësore dhe dytësore për të gjitha konfliktet në ish-Jugosllavi për qëllime përkujtimi.

në ndryshimin e perspektivës, por nuk shoh shumë mundësi, sepse shumica e organizatave drejtohen nga të njëjtët njerëz dhe konsumohen, ata kanë punuar për shumë vjet dhe nuk janë në gjendje të shohin përtej asaj që kanë bërë».[62] Për më tej, ky aktivist deklaroi: «Nëse nuk ndjekin agjendën e donatorëve, OJQ-të fatkeqësisht kërcënohen me ndërprerjen e fondeve», duke shtuar se prandaj «mendoj se është me rëndësi t'u drejtohemi qasjeve të udhëhequra nga qytetarët për t'u marrë me të kaluarën».[63] Ngjashëm, një gazetar serb i Kosovës pohoi: «Organizatat e shoqërisë civile ndonjëherë janë në flluskë dhe punojnë vetëm me disa njerëz», duke shtuar se ajo që mungon është të pasja e «më shumë njerëzve, nga fshatra, qytete të ndryshme, që mund të tregojnë se çka mendojnë».[64] Ndërsa shoqatat e më të prekurve nga konflikti (personat e zhdukur, të mbijetuarit, të burgosurit politikë, dhe veteranët e invalidët) luajnë rol të rëndësishëm për përfaqësimin e nevojave dhe interesave të anëtarëve të tyre, të anketuarit kanë theksuar edhe funksionin e heshtjes përjashtuese që këto grupe mund të kenë tek individët. Siç tha një i anketuar, viktimat shpesh ndjehen të nën-përfaqësuara, duke pretenduar se «disa shoqata» ua kanë kufizuar negativisht pjesëmarrjen, pasi udhëheqësit e shoqatave të tilla kanë patronizuar organizatën dhe kanë humbur kontaktin me ata që i përfaqësojnë.[65] Prandaj, duhet pasur një dallim midis komuniteteve të viktimave/të mbijetuarve, shoqatave të viktimave të themeluara, si dhe OJQ-ve që merren me viktimat.[66]

Në vitin 2017, Presidenti aktual i Kosovës, Hashim Thaçi, lansoi procesin për krijimin e një Komisioni të së Vërtetës dhe Pajtimit (KVP) për të «promovuar të vërtetën dhe pajtimin, si dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut».[67] Deri më tani është themeluar vetëm një ekip përgatitor i cili është i përbërë prej individësh nga qeveria dhe shoqëria civile, si dhe nga ekspertë të pavarur, roli i të cilëve është të hartojnë aspektet ligjore, institucionale dhe operacionale të Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin.[68] Ekipi përgatitor ka një qëllim ambicioz për një KVP eventuale: «të dokumentojë dhe të përcaktojë fakte të shkeljeve të të drejtave të njeriut të kryera gjatë të kaluarës së dhunshme të fundit, duke rivendosur dinjitetin e viktimave të të gjitha komuniteteve dhe të kontribuojë në transformimin shoqëror për të parandaluar përsëritjen e shkeljeve dhe abuzimeve të pësuara".[69] Ekipi përgatitor është zotuar të promovojë gjithëpërfshirjen, transparencën dhe integritetin si parime udhëzuese në krijimin e KVP-së. Në këtë frymë, ata kanë organizuar konsultime publike me një varg palësh interesi në Kosovë për të diskutuar mandatin dhe shtrirjen e KVP-së. Në vitin 2020, ekipi përgatitor ka hartuar aktin normativ në KVP, i cili përshkruan mandatin, përbërjen dhe përgjegjësitë e këtij organi, që parashikohet të themelohet në të ardhmen e afërt. Ndër qëllimet themelore të tij është të promovojë një proces nga poshtë-lart për të zbuluar të vërtetën lidhur me shkeljet e mëdha të të drejtave të njeriut duke «aftësuar personat të ofrojnë perspektivat dhe motivet e tyre për shkelje të tilla, të përgjegjshme për komisionin e shkeljeve të të drejtave të njeriut».[70] Në veçanti, ai synon «të depërtojë dhe t'i identifikojë viktimat dhe komunitetin e viktimave, dhe t'u ofrojë viktimave mundësi për të shprehur, publikisht ose privatisht, versionin e tyre të shkeljeve ose dëmtimeve të përjetuara, si dhe të shprehin nevojat e tyre».[71] Kjo parashikohet përmes dëgjimeve të hapura dhe të mbyllura dhe konsultimeve e ndërveprimeve të tjera në terren me komunitetet e prekura.[72]

Me gjithë përpjekjet për krijimin e KVP, ende ka shqetësime për qëndrueshmërinë e kësaj nisme. Ndonëse njihen përpjekjet e ekipit përgatitor për t'u këshilluar me palët e interesuara përkatëse në këtë fazë të hershme, disa segmente të shoqërisë civile kanë përmendur rëndësinë e zgjerimit të përfshirjes së të gjitha komuniteteve të prekura në këtë proces.[73] Për këtë, ekipi përgatitor tashmë parashikon të zgjerojë përfshirjen dhe të depërtojë te komunitetet e prekura në muajt e ardhshëm, si dhe të rrisë vetëdijesimin e publikut për qëllimin, mandatin dhe fushëveprimin e funksionimit të KVP.[74] Mbetet gjithashtu një pyetje në lidhje me perspektivat e arritjes së pajtimit përmes KVP në kushtet kur komunitetet viktima nuk konsultohen sa duhet, si në mesin e komuniteteve pakicë, një numër i madh i të cilëve aktualisht jetojnë në Serbi.[75] Të tjerët kanë hedhur dyshime nëse nisma e KVP ka dalë me qëllim të baraspeshimit të përgjegjësisë dhe zbutjes së ndikimit eventual të Dhomave të Specializuara në esablishmentin e tanishëm politik.[76]

Për më tej, ka shqetësime se nisma për KVP ishte lansuar pa një vizion më të gjerë se si të përfshihen iniciativat ekzistuese, si KOMRA, apo të mbindërtohet në Grupin Punues Ndërministror për Trajtimin e të Kaluarës dhe Pajtimin (GPNM-TKP), i cili pushoi së ekzistuari pa një vendim zyrtar, pak pas fillimit të nismës KVP.[77] Shumica e të anketuarve kanë identifikuar shoqërizimin dhe personalizimin e nismave të drejtësisë tranzicionale me udhëheqës politikë të caktuar si pengesë kryesore për ndërtimin e një infrastrukture institucionale të qëndrueshme për DWP në Kosovë. Kur arkitekti i nismës largohet nga zyra, qeveritë pasardhëse priren të fillojnë nismën e tyre, e cila rrënon vazhdimësinë dhe suksesin e çdo përpjekjeje për t'u marrë me të kaluarën në Kosovë. Një zyrtar qeveritar pranoi se: «pothuajse të gjitha nismat varen nga personi që i fillon, dhe kur ai ndryshon pozitën ose largohet, edhe nisma përfundon».[78] Në përgjigje të këtyre shqetësimeve, disa të anketuar kanë propozuar një rol më të madh për Kuvendin e Kosovës lidhur me KVP-në për të siguruar legjitimitet dhe konsensus të gjerë politik, si dhe pronësi më të gjerë për komunitetet joshumicë.[79] Si një i anketuar serb pohoi: «problemi janë ata që propozojnë këta mekanizma, dhe meqenëse këto nisma nuk po kalojnë në Parlament, pëgjithësisht kanë mungesë legjitimiteti».[80]

62. Intervista C. 03 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.
63. Intervista C. 03 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.
64. Intervista R. 31 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.
65. Intervista O. 30 mars 2020, Prishtinë, Kosovë
66. Intervista D. 05 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.
67. Presidenti i Kosovës, 'Draft rregullore mbi Komisionin për të vërtetën dhe pajtimin', Prishtinë 20 prill 2017.
68. Presidenti i Kosovës, Vendimi për Emërimin e Ekipit Përgatitor. Prishtinë, 2018. Gjendet në: https://president-ksgov.net/repository/docs/2019_10_16_125802_DECISION_ON_THE_APPOINTMENT_OF_THE_PREPARATORY_TEAM_15102019.pdf.
69. Presidenti i Kosovës, 'Deklarata për Emërimin e Ekipit Përgatitor'. Prishtinë, 2018, f. 2. Gjendet në: https://president-ksgov.net/repository/docs/2019_01_17_143401_DECLARATION17119.pdf.
70. Presidenti i Kosovës, 'Projekt Akti Normativ Nr. XX / 2020 mbi KVP', neni 19.1.1.3, f. 13. Gjendet në: https://president-ksgov.net/repository/docs/2020_01_28_103348_Normative_Act_eng_for_web_jan2020.pdf, neni 19.1.1.3, fq. 13.
71. Presidenti i Kosovës, 'Projekt Akti Normativ Nr. XX / 2020 mbi KVP', neni 19.1.1.3, f. 13. Gjendet në: https://president-ksgov.net/repository/docs/2020_01_28_103348_Normative_Act_eng_for_web_jan2020.pdf.
72. Intervista H. 12 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.
73. Intervista C. 03 mars 2020, Prishtinë, Kosovë. Fokus Grupi 1, 06 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.
74. Integra dhe New Social Initiative (NSI), studimi i perceptimit publik dhe dialogu publik rreth Komisionit të të Vërtetës dhe të Pajtimit të Kosovës (KVP) të Kosovës ', 2020, f. 6. Ky sondazh tregon se shumica e të anketuarve (72%) kurrë nuk kanë dëgjuar për iniciativën për një KVP për Kosovën.
75. Intervista G. 10 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.
76. Intervista O. 30 mars 2020, Prishtinë, Kosovë
77. Intervista C. 03 mars 2020, Prishtinë, Kosovë. Për më shumë mbi IMWG-TsK shih faqen 27.
78. Intervista D. 05 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.
79. Intervista L. 25 Mars 2020, Prishtinë, Kosovë.
80. Intervista O. 30 mars 2020, Prishtinë, Kosovë

Dëmshpërblimet

Dëmshpërblimet konsiderohen si aspekt thelbësor për ofrimin e kompensimit e viktimave, rehabilitimin dhe garancitë për mospërsëritjen e krimeve të mëparshme. Serbia nuk ka paguar asnjë dëmshpërblim për dëmet dhe humbjet e jetëve nga fushata e saj ushtarake dhe policore në Kosovë. Ka një perceptim të gjerë të mohimit të krimeve të luftës dhe mosnjohjes së të drejtave të viktimave.[81] Në mungesë të dëmshpërblimit zyrtar nga Serbia, Qeveria e Kosovës ofron dëmshpërblime në formën e pensioneve dhe privilegjeve të tjera për veteranët e luftës, invalidët dhe familjet e dëshmorëve të luftës së UÇK-së; viktimat civile dhe të mbijetuarit e viktimat e dhunës seksuale gjatë konfliktit; si dhe të burgosurit politikë dhe civilët e dëmtuar fizikisht. Ndihma për këto kategori rregullohet me ligje specifike dhe zbatohet nga struktura institucionale specifike. Ligji për Dëmshpërblime i vitit 2014 priret të favorizojë kryesisht viktimat shqiptare të Kosovës, ndërsa viktimat civile që u përkasin grupeve të tjera etnike përjashtohen pasi ato të afërta me 'forcat armike' ose krimet që i prekin ata bien jashtë afatit kohor të mbuluar nga ligji.[82] Të ardhurat mujore të kategorive të përfituesve të lidhur me UÇK-në janë pothuajse dyfishi i asaj që marrin viktimat civile ose familjet e personave të zhdukur.[83] Rreth 38.000 veteranë të UÇK-së përfitojnë një pension bazë mujor, nga të cilët mbi 90% janë meshkuj dhe shqiptarë të Kosovës.[84] Ekziston një dyshim i besueshëm se numri i veteranëve të UÇK-së mund të jetë dyfishuar krahasuar me ata që vërtet kanë marrë pjesë aktivisht në luftën e rezistencës, siç reflekton një rast aktakuze nga prokurorët e Kosovës.[85]

Pas më se një dekade nga neglizhenca prej autoriteteve ndërkombëtare e shtetërore në Kosovë, Kuvendi i Kosovës më 2014 u dha njohje juridike të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë konfliktit, çka hapi rrugën që të mbijetuarve të dhunës seksuale të lidhur me konfliktin t'u ofrohet statusi i viktimave civile dhe t'u jepen dëmshpërblime në formën e pensionit mujor. Deri në vitin 2014, të mbijetuarit dhe viktimat e dhunës seksuale nuk njiheshin si kategori në asnjë ligj që ofronte dëmshpërblim për viktimat ushtarake dhe civile të luftës. Kjo ishte tejet shqetësuese pasi këto krime përbëjnë krime lufte të torturave dhe është gjetur se kanë qenë aq sistematike sa të përbëjnë krime kundër njerëzimit.[86] Plotësim-ndryshimi u ofroi të mbijetuarve femra dhe meshkuj njohjen publike dhe të drejtën për të aplikuar për dëmshpërblim administrativ.

Sidoqoftë, atyre iu desh të prisnin deri në vitin 2018 që të mund të aplikonin për statusin e të mbijetuarit të dhunës seksuale në kohë lufte dhe të marrin kompensim në trajtën e pagesës mujore, si dhe disa forma të tjera të kufizuara dëmshpërblimi.[87] Në vitin 2018, u krijua Komisioni Qeveritar për Verifikimin dhe Njohjen e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale në Kosovë për të avokuar për mbështetje të vazhdueshme institucionale dhe pranim shoqëror për ata që preken nga dhuna seksuale gjatë konfliktit. Vlerësohet se rreth 20.000 gra dhe vajza të reja janë dhunuar seksualisht gjatë konfliktit.[88] Sidoqoftë, këto shifra janë kontestuar pasi nuk ka prova të mjaftueshme për t'i provuar abuzimet e tilla.[89] Vlerësohet se deri më tani vetëm 1.438 gra gjithsej marrin pension.[90] Megjithëse dispozita aktuale shënoi një hap të rëndësishëm përpara për viktimat e dhunës seksuale, ligji prapë është kritikuar si i largët prej standardeve ndërkombëtare për viktimat e krimeve sipas ligjit ndërkombëtar.[91] Nuk ia del të ofrojë dëmshpërblimin e duhur dhe t'ua kthejë gjendjen fillestare të mbijetuarve para se të ndodhin shkeljet e mëdha të të drejtave të njeriut, përfshirë qasjen në prona dhe shërbime rehabilitimi.[92] Së pari, afati kohor i pranueshmërisë përfundon më 20 qershor 1999, duke diskriminuar kështu ata që u dhunuan pas kësaj date, kryesisht serbë të Kosovës, romë dhe disa gra shqiptare. Ka njëfarë frike se në mesin e komuniteteve pakicë jombizotëruese, si gratë rome, ato nuk kanë dalë të kërkojnë dëmshpërblim nga frika e stigmës, presioni dhe përjashtimi nga grupi ose shoqëria.[93] Së dyti, ata që tashmë marrin një pagesë tjetër lidhur me luftën, u ndalohet të marrin dy pensione dhe duhet të zgjedhin se cilin përfitim dëshirojnë ta marrin.[94]

Përkundër këtyre sfidave, të anketuarit ishin shumë pozitivë për procesin e avokimit dhe zhvillimin e infrastrukturës ligjore dhe institucionale për njohjen dhe mbështetjen e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë konfliktit.[95] I gjithë procesi përfshinte të gjithë aktorët përkatës, përfshirë komunitetet e prekura dhe ia doli të gjenerojë jo vetëm konsensus politik, por edhe admirim të gjerë vendor dhe ndërkombëtar.[96]

Garancitë e mospërsëritjes dhe reformat institucionale

Garancitë e mospërsëritjes janë thelbësore për TsK dhe ndërtimin e një të ardhmeje paqësore. Ato përfaqësojnë një gamë të gjerë masash institucionale dhe politike, të ndërmarra për t'u siguruar se abuzimet e kaluara të të drejtave të njeriut nuk do të përsëriten. Kjo shpesh përfshin reformimin e institucioneve politike, gjyqësore dhe të sigurisë. Edhe pse Kosova nuk kishte institucione plotësisht të pavarura para konfliktit të dhunshëm dhe prandaj nuk mban përgjegjësi për shkelje të mëdha të të drejtave të njeriut të kryera nga institucionet shtetërore serbe para luftës, nën tutelën dhe mbikëqyrjen ndërkombëtare janë ndërmarrë një gamë aktivitetesh që garantojnë mospërsëritjen e shkeljeve të kaluara të të drejtave të njeriut në territorin e Kosovës.

81. Konsultim me grupin e shoqërisë civile në Kosovë, 20 maj 2020, online.
82. Shih: Humanitarian Law Center, 'War Reparations for Civilian Victims: What Access for Communities', 2016, f. 87-88. Gjendet në: https://www.hlc-kosovo.org/wp-content/uploads/2018/07/HLC_Report_final-REPARACIJE-eng.pdf.
83. Këto kategori përfshijnë: veteranët e luftës së UÇK-së, invalidët dhe familjet e dëshmorëve.
84. Agjencia e Statistikave e Kosovës, 'Statistikat e mirëqenies', Prishtinë, 2019, f. 33. Gjendet në: https://ask.rks-gov.net/media/5336/statistikat-e-mirëqenies-sociale-tm4-2019.pdf.
85. Kosova Press, 'OVL-UÇK: Mbi 2000 persona janë larguar nga lista e përfituesve të pensionit të veteranëve të luftës, Prishtinë, Mars 2020. Gjendet në: https://kosovapress.com/ovl-uck-mbi-2-mije-persona-jane-larguar-nga-lista-e-perfituesve-te-pensionit-si-veterane/.
86. Amnesty International, 'Wounds that burn our souls: Compensation for Kosovo's Wartime Rape Survivors, But Still No Justice'. Londër, 2017. Gjendet në: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20171213144511741.pdf.
87. Kjo ka ardhur si rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme të lobimit nga OShC-të, të tilla si QRVT, që me efektshmëri kanë arritur të bindin Qeverinë e Kosovës në dhjetor 2017 të miratojë buxhet në mbështetje të të mbijetuarve të dhunës seksuale.
88. Serbeze Haxhiaj, 'The Enduring agony of wartime rape, Pristina, 2017. Gjendet në: https://balkaninsight.com/2017/05/29/agony-of-wartime-rape-victims-endures-in-kosovo-05-28-2017-1/.
89. Intervista N. 26 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.
90. Intervista G. 10 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.
91. Intervista K. 20 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.
92. Intervista P. 30 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.
93. Konsultime me grupin e shoqërisë civile në Kosovë, 20 maj 2020, online.
94. Intervista K. 20 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.
95. Intervista O. 30 mars 2020, Prishtinë, Kosovë
96. Denis Foundation, 'Ukrainian SEMA members develop their vision to bring justice to survivors by learning about the compensation procedure in Kosovo', Gjendet në: https://www.mukwegefoundation.org/2019/10/ukrainian-sema-members-develop-their-vision-to-bring-justice-to-survivors-by-learning-about-the-compensation-procedure-in-kosovo/.

Agjenda ndërkombëtare për ndërtimin e paqes në Kosovë u përqëndrua në mbështetjen e shumtnicitetit përmes akomodimit dhe sistemimit të komunitetit serb nëpërmjet vetëqeverisjes lokale të zgjeruar, kthimit të qëndrueshëm të personave të zhvendosur, privilegjeve institucionale dhe mbrojtjes së veçantë të trashëgimisë fetare dhe kulturore.[97] Nën UNMIK-un dhe më vonë bazuar në Propozimin e Ahtisaari-t,[98] Kosova hartoi një sistem kushtetues dhe politik i cili siguron përfaqësim të gjerë politik dhe të drejta të zgjeruara për komunitetet pakicë në nivel kombëtar dhe lokal. Kjo përfshin policinë, forcat e sigurisë dhe gjykatat shumetnike që kanë dispozita institucionale për të respektuar të drejtat e njeriut, përfshirë këtu të drejtat e grave dhe të pakicave.

Pas shpalljes së pavarësisë më 2008, Kosova mori përsipër detyrime për t'u marrë me të kaluarën përmes hartimit të një strategjie kombëtare për drejtësi tranzicionale. Nën udhëheqjen e Ministrisë së Drejtësisë, në vitin 2012 u krijua një Grup Punues Ndërministror për Trajtimin e të Kaluarës dhe Pajtimin (GPNM-TKP), roli i të cilit ishte të merrte «parasysh pikëpamjet e viktimave të të gjitha komuniteteve në Kosovë» që do të përfshiheshin në një Strategji Kombëtare për Drejtësinë Tranzicionale.[99] GPNM-TKP përbëhej nga anëtarë prej 12 ministrive dhe tetë përfaqësues të shoqërisë civile. Ishte menduar të ishte pikë fokale që do të lehtësonte dhe mbështeste «dialogun dhe bashkëpunimin midis grupeve të synuara, institucioneve shtetërore, organizatave joqeveritare dhe bashkësisë ndërkombëtare».[100] Në veçanti, GPNM-TKP kishte një mandat të gjerë depërtimi me «kryerje konsultimesh duke u dhënë grupeve të synuara hapësirë për të shprehur shqetësimet dhe duke mbështetur mundësinë për pronësi» si dhe «inkurajim të pjesëmarrjes së përfaqësuesve të popullatës së prekur, si dhe OJQ-ve duke i lejuar të marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e nismave të drejtësisë tranzicionale».[101] Përtej hartimit të rregullores dhe të planit të punës, i cili parashikonte një gamë konsultimesh publike, GPNM-TKP nuk arriti të përmbushte mandatin e vet. Në fund, GPNM-TKP zyrtarisht pushoi së funksionuari në vitin 2018 pasi nuk arriti të zhvillonte një strategji kombëtare për drejtësinë tranzicionale.

Siç pohonte një aktivist i shoqërisë civile, mbase i vetmi aspekt pozitiv i kësaj nisme është se e mbajti gjallë bisedën mbi nevojën për një qasje të duhur dhe strategjike ndaj drejtësisë tranzicionale.[102] As nuk ia ka dalë të konsultohet me komunitetet e prekura dhe as të hartojë strategjinë e shumëpritur e cila fillimisht planifikohej të përfundonte më 2017. GPNM-TKP u përball me shumë sfida duke përfshirë probleme të brendshme procedurale dhe thelbësore, si udhëheqje dhe menaxhim inadekuat, mungesë e pronësisë politike, përfaqësim dhe pjesëmarrje e dobët e komuniteteve pakicë të Kosovës dhe dështim i përgjithshëm për përfshirjen e publikut më të gjerë. GPNM-TKP duhej të promovonte përfshirjen, ndjeshmërinë gjinore, gjithëpërfshirjen dhe konsultimet e gjera publike, si kritere kyçe që udhëzojnë procesin e trajtimit të së kaluarës dhe pajtimit në Kosovë. Plani i Punës i GPNM-TKP parashikonte të zhvillonte të paktën tri konsultime me palët e interesuara përkatëse për secilin aspekt të drejtësisë tranzicionale (e vërteta, drejtësia, dëmshpërblimet dhe garancitë e mospërsëritjes dhe reformat). Ky Plan i Punës pranoi qartë se «konsultimet dhe diskutimet synojnë: të sigurojnë që strategjia të përmbushë nevojat reale të kategorive të viktimave dhe të shoqërisë në përgjithësi, si dhe të krijojë mundësi për të eksploruar atë që shteti mund të ofrojë ashtu që të jetë e pranueshme nga viktimat dhe shoqëria".[103] Sidoqoftë, siç u shpalos më vonë, «nuk është dhënë asnjë informatë mbi hapat e mëtejshëm të parashikuar për kryerjen e këshillimeve».[104]

Përshtypja mbizotëruese në mesin e të anketuarve është se modeli dhe mandati i GPNM-TKP u imponua nga bashkësia ndërkombëtare dhe qeveria e Kosovës, pa konsultim paraprak me organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetet e prekura, si shoqata e viktimave dhe personave të zhdukur. Siç tha një aktivist i shoqërisë civile: «Grupi ndërministror i punës ishte kërkesë e ndërkombëtarëve në Kosovë – ishte nismë nga jashtë, prandaj nuk i përmbushi pritshmëritë… kjo nismë dështoi sepse ishte ide nga jashtë dhe nuk filloi natyrshëm».[105] Për më tej, GPNM-TKP nuk kishte udhëheqje të duhur për të mbikëqyrur zbatimin e planit të veprimit. Grupi nuk takohej rregullisht. Një ish-anëtar i tij pranoi: «GPNM-TKP dështoi në përgatitjen e strategjisë sepse grupi ishte i madh dhe nuk kishte vullnet politik që të kishte sukses. Grupi kryesohej nga Zyra e Kryeministrit dhe kishte dy zëvendës – kjo strukturë nuk ishte shumë e qartë dhe rezultoi me shumë paqartësi".[106]

As shoqëria civile dhe as përfaqësuesit e qeverisë nuk kishin ekspertizë dhe aftësi për ta trajtuar mandatin gjithëpërfshirës e kompleks të GPNM-TKP. Ngjashëm, ekspertiza ndërkombëtare ishte e pamjaftueshme për ta udhëhequr punën e këtij organi.[107] Tensionet dhe mosmarrëveshjet midis përfaqësuesve të qeverisë dhe shoqërisë civile mbi pronësinë e procesit dhe ekspertizën po ashtu e rrënuan punën e GPNM-TKP. Një aktivist i shoqërisë civile dhe ish-anëtar i GPNM-TKP pranoi se «nuk kishte udhëheqësi dhe as përkushtim. Zyra e Kryeministrit duhej të kryesonte GPNM-TKP, por i ndryshuan disa njerëz në këtë post, çka tregon se nuk kishte zotim që kjo nismë të kish sukses".[108] Për më tej, Qeveria e Kosovës nuk ia doli të angazhonte mjetet e nevojshme për të vazhduar aktivitetet këshilluese të GPNM-TKP, ndërsa ndihma e donatorëve dukshëm përjetoi disa mangësi. Një zyrtar qeveritar e pranoi se «përsëritej një gabim: institucionet nuk merrnin parasysh mendimin e viktimave dhe të qytetarëve, të cilët shpesh liheshin jashtë dhe zëri nuk u dëgjohej».[109] Për më tej, komunitetet pakicë u përfshin vetëm sipërfaqësisht në punën e GPNM-TKP. Në fund, GPNM-TKP ishte kryesisht e shkëputur nga proceset e tjera të drejtësisë tranzicionale në Kosovë, duke mos ia

97. Gëzim Visoka, Shaping Peace in Kosovo: The Politics of Peacebuilding and Statehood, Basingstoke: Palgrave Macmillan, 2017.

98. Plani i Ahtisaari-t është një shkurtesë për 'Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës' nga i Dërguari Special i OKB për Kosovën Martti Ahtisaari, i lëshuar në mars 2007 në përpjekje për të arritur një zgjidhje përfundimtare midis Kosovës dhe Serbisë. Pas dy vjet bisedimesh, Plani i Ahtisaari-t, i cili propozoi pavarësi të mbikëqyrur për Kosovën, u refuzua nga Serbia dhe nuk u paraqit në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, në parashikim të vetos nga Rusia dhe Kina. Më pas, Kosova me mbështetjen e Shteteve të Bashkuara dhe shumicës së vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, shpalli pavarësinë më 17 shkurt 2008 dhe mori përsipër detyrimet për zbatimin e këtij Plani, i cili u mbështet nga një Zyrë Civile Ndërkombëtare dhe zgjati deri në shtator të vitit 2012. Për më shumë detaje shih: UN Security Council, "Comprehensive Proposal for the Kosovo Status Settlement', Doc. S/2007/168/Add.1, 26 mars 2007.

99. Qeveria e Kosovës, 'Draft Vendimi për krijimin e një grupi punues ndërministror për trajtimin e të kaluarës dhe pajtimit', Doc. Nr. 03/77, 04 qershor 2012, f. 3.

100. 'Propozim Vendimi për krijimin e një grupi punues ndërministror për trajtimin e të kaluarës dhe pajtimit', f. 3.

101. Po aty, faqe 4.

102. Intervista L. 25 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

103. Qeveria e Kosovës, 'Plani i Punës për Hartimin e Strategjisë Kombëtare për Drejtësinë Tranzicionale në Kosovë (2015-2017)', f. 2.

104. Shih: Nora Ahmetaj dhe Thomas Unger, 'Kosovo's Framework for Dealing with the Past at a Turning Point" Civil society review of the progress towards a National Strategy on Transitional Justice', Impunity Watch, CPT, Integra and PAX, Prishtinë, prill 2017, f. 8. Gjendet në: http://www.impunitywatch.org/docs/Civil_society_review_report_final_ENG_8.51.pdf.

105. Intervista O. 30 mars 2020, Prishtinë, Kosovë

106. Intervista T. 21 prill 2020, Prishtinë, Kosovë.

107. Për shembull, të intervistuarit kanë ngritur shqetësime lidhur me ndikimin e kufizuar të një projekti të udhëhequr nga UNDP për të përkrahur GPNM-TKP që të hartojë strategji gjithëpërfshirëse të drejtësisë tranzicionale,të përqendruar në viktima dhe të ndjeshme ndaj gjinisë. Për më shumë detaje, shih përmbledhjen e projektit: UNDP, "Support to Transitional Justice in Kosovo'. Gjendet në: https://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/operations/projects/democratic_governance/support-to-transitional-justice-in-kosovo.html.

108. Intervista G. 10 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

109. Intervista D. 05 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

dalë të marrë rol udhëheqës në bashkërendimin dhe integrimin e përpjekjeve të ndryshme për TsK dhe pajtim në Kosovë.

Qeveria e Albin Kurtit, e cila erdhi në pushtet në shkurt 2020, por humbi me votën e mosbesimit në Kuvendin e Kosovës pas një muaji, nuk parashikoi një strategji të re shtetërore për drejtësinë tranzicionale. Në vend të kësaj, në programin e plotë qeveritar (i miratuar më 06 mars 2020) premtohej forcimi i kapaciteteve institucionale ekzistuese për hetimin, gjykimin dhe dokumentimin e krimeve të luftës. Vizioni i tyre përfshinte kanalizimin e masave të drejtësisë tranzicionale përmes Ministrisë së Drejtësisë dhe riorganizimin e përbërjes së saj institucionale për ta përmirësuar mbledhjen e të dhënave për dëmet e luftës dhe për t'i ndihmuar mekanizmat dhe iniciativat e tjera të drejtësisë tranzicionale.[110] Në maj 2020, Ministria e Drejtësisë themeloi një grup pune për të kryer një analizë të modaliteteve për themelimin e një instituti të ri të hulumtimit të krimeve të luftës.[111] Një institut i ngjashëm i vendosur në Ministrinë e Drejtësisë u shpall i tepërt para dy vjetësh nga Qeveria paraprake.[112] Për më tej, ai parashikohet të përputhet në Konventat e Gjenevës, përfshirë Konventën e Gjenocidit, dhe të përgatisë një padi kundër Serbisë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë.[113]

Përtej Qeverisë së Kosovës, Kuvendi i Kosovës ka luajtur rol të kufizuar deri më tani në realizimin e TsK. Përtej mbajtjes së përgjegjësisë që të shqyrtojë dhe të miratojë legjislacion, ai është angazhuar kryesisht në debate retorike që promovojnë narracione dhe agjenda një-etnike. Ndarja kushtetuese e pushteteve ka kufizuar aftësinë e Kuvendit të Kosovës që të luajë rol më aktiv në mbikëqyrjen dhe mbajtjen përgjegjëse të institucioneve gjyqësore në Kosovë që merren me përgjegjësitë e krimeve të luftës. Qeveria dhe presidenca kanë ndjekur nismat vetjake duke anashkaluar Kuvendin e Kosovës nga frika se fraksionet politike brenda organit legjislativ do të përfundonin në diskutime pa mbarim dhe do ta bllokonin çfarëdo përparimi.[114] Ngjashëm, mungesa e kompetencave ligjore për ta mbikëqyrë punën e misioneve dhe mekanizmave ndërkombëtarë që veprojnë në Kosovë para dhe pas pavarësisë më 2008, kanë penguar mundësinë e Kuvendit të Kosovës që të luajë rol më aktiv në sigurimin e përgjegjësisë demokratike të gjykatave krimeve të luftës, ndërkombëtare dhe hibride, në Kosovë.

Në vitin 2019, Kryetari i Kuvendit të Kosovës shpalli krijimin e një gjykate ndërkombëtare për të gjykuar krimet e Serbisë të kryera gjatë luftës në Kosovë. Nisma parashikonte një komision parlamentar ad hoc për të hartuar një rezolutë dhe dokumente të tjera ligjore për krijimin e gjykatës.[115] Si pjesë e kësaj nisme u diskutua edhe ideja e krijimit të një komisioni shtetëror të përbërë nga qeveria, opozita dhe partitë minoritare, shoqatat e luftës së UÇK-së, institucionet gjyqësore, shoqëria civile dhe akademia. Roli i tij do të ishte mbledhja e provave mbi krimet e luftës dhe hartimi i një plani veprimi. Ndonëse nisma u mbështet nga Presidenti dhe Ministri i atëhershëm i Drejtësisë, dhe shoqatat e shqiptarëve të Kosovës për persona të zhdukur, ajo nuk është zbatuar ende pasi zgjedhjet kombëtare të tetorit 2019 ndryshuan përbërjen e parlamentit

110. Intervista S. 01 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

111. Ministria e Drejtësisë, Vendimi 45/2020, 13 maj 2020. Gjendet në: https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/4909C5D9-68F3-4CE0-BDD9-533A367E6C19.pdf.

112. Shih diskutimin në faqet 19-20 të këtij studimi.

113. Koha Ditore, 'Programi i Qeverisë së Kurtit me 45 faqe ', 6 mars 2020. Gjendet në: https://www.koha.net/arberi/212049/ekskluzive-programi-45-faqesh-i-qeverise-kurti/.

114. Intervista C. 03 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

115. Radio Evropa e Lirë, 'Nisma për Tribunalin për krimet serbe është zyrtare', Prishtinë, 6 maj 2019. Gjendet në: https://www.evropaelire.org/a/tribunal-per-krimet-e-serbise-ne-kosove-/29924688.html.

dhe të qeverisë. Për më tej, ekspertët juridikë kanë hedhur dyshime mbi seriozitetin e kësaj nisme, duke argumentuar se ekzistojnë kufizime ligjore dhe mungesë e mbështetjes ndërkombëtare për një iniciativë të tillë.[116] Nisma duket se ka të bëjë më shumë me kundërpeshimin e Dhomave të Specializuara me shpresën se në të ardhmen mandati i tyre, që aktualisht shënjestron vetëm krimet e luftës të pandehura nga UÇK-ja do të zgjerohet për të përfshirë edhe raste të pazgjidhura të krimeve të luftës të kryera nga policia dhe forcat ushtarake serbe.[117]

Edhe përpjekjet për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë nën kujdesin e BE-së që nga viti 2011 mund të konsiderohen si masa të destinuara për të ofruar garanci për mospërsëritjen e krimeve të të kaluarës. Si pjesë e dialogut teknik dhe politik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, u arritën një numër marrëveshjesh të rëndësishme për bashkëpunimin rajonal dhe përfaqësimet, menaxhimin e integruar të kufijve, rregullimin e doganave, kthimin e regjistrave kadastralë dhe të regjistrit civil, si dhe njohjen e diplomave universitare. Megjithatë, i gjithë procesi i normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është cilësuar si proces i bërjes së kompromiseve me gjysmë zemre gjatë bisedimeve teknike dhe politike. Ky proces i normalizimit deri tani nuk ka kontribuar në përmirësim thelbësor të marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë.[118] Qasja e BE-së për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka qenë nga lart-poshtë dhe kryesisht e përqendruar në nivele shtetërore. Megjithëse BE miratoi kornizën e vet mbi drejtësinë tranzicionale më 2015, ajo e shmangu integrimin e saj në dialogun Kosovë-Serbi.[119] Që prej fillimit të dialogut, tema të ndjeshme, siç janë personat e pagjetur ose bashkëpunimi ndërkufitar për hetimin e krimeve të luftës, janë lënë mënjanë nga BE-ja nga frika se tema të tilla do t'i shpërudhnin masat e ndërtimit të besimit dhe përpjekjet për normalizimin gradual të marrëdhënieve të ndërsjella.[120]

Aktorët vendorë, komunitetet e prekura dhe grupet e shoqërisë civile në Kosovë e Serbi nuk janë përfshirë në diskutimin se si të normalizohen këto marrëdhënie që ndikojnë në përditshmërinë e tyre, që është vënë si qëllimi kryesor i dialogut. Raporti më i fundit i Grupit të Avokimit për Politika Kosovë-Serbi që përmbledh perceptimet e qytetarëve në terren gjeti se "procesi i përgjithshëm i dialogut teknik është shoqëruar me mungesë transparence prej të dyja qeverive dhe kjo ka kontribuar në nivelin e kufizuar të informacionit mes qytetarëve për procesin dhe rezultatet e tij».[121] Rrjedhimisht, mungesa e përfshirjes ka rezultuar me mungesë legjitimiteti lokal, çka ka rrënuar efektivitetin e të gjithë procesit. Nevojat, interesat dhe perspektivat e qytetarëve përfaqësohen zbehtas dhe ndërmjetësohen nga teknokratë prej të dyja palëve, dhe janë negociuar nga përfaqësuesit politikë.
Përkundër këtyre masave institucionale e ligjore, mungesa e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse të paqes dhe marrëdhënieve të normalizuara midis Serbisë dhe Kosovës vazhdon të ushqejë nacionalizmin dhe të pengojë pajtimin midis grupeve etnike në të dyja anët e kufirit.[122] Të orientuara drejt drejtësisë ndëshkuese, institucionet hibride gjyqësore në Kosovë kanë qenë objekt

116. Gazeta Express, 'Ideja e Veselit për gjykatë për krimet serbe po konsiderohet kundërligjore', Prishtinë, 2019. Gjendet në: https://www.gazetaexpress.com/ideja-e-veselit-per-gjykate-per-krimet-serbe-po-konsiderohet-kunderligjore-xx/.

117. Intervista C. 03 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

118. Intervista P. 30 mars 2020, Prishtinë, Kosovë

119. Intervista C. 03 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

120. Intervista R. 31 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

121. Kosovo – Serbia Policy Advocacy Group, 'Pristina – Belgrade Technical dialogue Agreements: Perceptions on the Ground', shkurt 2020, Prishtinë, Mitrovicë e Veriut, Beograd, f. 5. Gjendet në: http://ks-pag.org/en/kosovo-serbia-dialogue-pristina-belgrade-technical-agreements-perception-on-the-ground.

122. Gëzim Visoka, 'Everyday Peace Capture: Nationalism and the Dynamics of Peace after Violent Conflict', Nations and Nationalism, Vol. 26, Nr. 2, 2020, pp. 431-466.

zënkash dhe rezistence në nivele politike dhe shoqërore, duke mundësuar dukshëm shfaqjen e dinamikës etno-nacionaliste të përkujtimit dhe dokumentimit një-etnik të krimeve të luftës, të synuara kryesisht drejt konsolidimit të pushtetit brenda grupit dhe delegjitimimit të të tjerëve. Rehabilitimi i kriminelëve të dënuar të luftës në jetën politike dhe mbrojtja e tyre nga institucionet shtetërore të Serbisë, dhe deri diku të Kosovës, nuk japin asnjë garanci për mospërsëritjen e abuzimeve të mëdha të të drejtave të njeriut. Shumica e masave të drejtësisë tranzicionale, të ndërmarra nga autoritetet e Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare në Kosovë kanë qenë të ndara nga çfarëdo ndërveprimi me homologët serbë. Dinamika dhe proceset paralele e të pabarabarta të TsK në të dyja anët e kufirit, përfundimisht i kanë rrënuar perspektivat për përfshirje të mirëfilltë me trashëgiminë e të kaluarës së dhunshme, dhe as nuk u ofron përmbyllje familjeve të viktimave dhe të mbijetuarve të luftës, dhe as nuk kontribuon në pajtimin dhe lëvizjen përpara.[123]

> *«Nëse nuk ka pajtim të vërtetë midis elitave politike, nuk mund të ketë pajtim midis njerëzve të zakonshëm, sepse sa kohë që ka këto narracionesh të riprodhuara nga politikanët, nuk mund të kemi proces përfitimi nga vartësit në të cilin narrativat e konflikteve ndryshojnë».[124]*

Në mungesë të një marrëveshjeje përfundimtare mes Kosovës e Serbisë, retorika e përsëritjes së luftës dhe dhunës etnike vazhdon të promovohet nga figura të caktuara politike në Serbi dhe në Kosovë. Veçmas, që kur erdhi në pushtet presidenti aktual Aleksandar Vuçiç, autoritetet serbe kanë filluar një fushatë të plotë për të rehabilituar kriminelët e luftës duke u dhënë qasje në media dhe në institucione publike, si dhe duke promovuar ligjërimin e tyre luftënxitës.[125] Deri më sot, asnjë garanci e mospërsëritjes nuk vjen nga ndjekja e krimeve të luftës prej autoriteteve serbe. Fondi për të Drejtën Humanitare zbuloi në vitin 2019 se «nuk mund të raportohet për përparim në ndjekjet penale të krimeve të luftës tash 44 muaj që nga miratimi i Strategjisë Kombëtare».[126] Për më tej, raporti gjente se «qëndrimet ndaj krimeve të luftës dhe gjykimeve për krime lufte në Serbi, gjatë disa muajve të fundit janë shënuar me promovim të vazhdueshëm publik të kriminelëve të dënuar të luftës».[127] Raporte shqetësuese janë botuar edhe rreth mbulimit të krimeve nga ana e Serbisë gjatë konfliktit në Kosovë të cilat «ishin të planifikuara dhe të porositura nga udhëheqësia më e lartë politike dhe policore e Serbisë dhe vazhdojnë të dërgojnë mesazhe negative për viktimat dhe komunitetet e prekura.[128]

Shumica e të anketuarve shqiptarë në Kosovë të këtij studimi e kanë vënë kërkimfaljen për krimet e të kaluarës dhe njohjen e shtetësisë së Kosovës nga Serbia në zemër të trajtimit të së kaluarës dhe pajtimit për hir të paqes në të ardhmen. Një kërkimfalje zyrtare nga autoritetet serbe për krimet e luftës dhe dëmet në Kosovë do të kontribuonte dukshëm në ecjen përpara.[129] Siç deklaroi një i anketuar: "Kur flasim për 'faljen', është e vështirë të falësh nëse kurrkush nuk kërkon falje. Prandaj është me rëndësi që Serbia së pari të kërkojë falje».[130] Një aktivist shqiptar i shoqërisë civile pohoi: "Do të ndihmonte shumë nëse Serbia e njeh Kosovën, gjithçka tjetër do të ishte më e lehtë. Nëse Serbia e njeh Kosovën, Serbia gjithashtu njeh të kaluarën».[131] Në mesin e komunitetit serb të Kosovës ekziston perceptimi mbizotërues se për ta marrja me të kaluarën është pranim i fajit për krimet e kryera nga ish-regjimi serb.[132] Ky pranim i fajit nuk vjen nga ndonjë ndjenjë e drejtësisë, por si reflektim i pafuqisë së tyre si një komunitet pakicë në Kosovë për të përcaktuar kushtet e drejtësisë tranzicionale. Sa për çështjen e njohjes, një i anketuar serb pohoi: «Kur flasim për pajtimin, serbët nuk janë të gatshëm të pajtohen dhe të pranojnë pavarësinë e Kosovës. Kështu, marrëveshja politike është shumë më e lehtë sesa pajtimi».[133] Në mesin e të anketuarve serbë të Kosovës ishte një perceptim i gjerë se mënyra më pragmatike e trajtimit të të kaluarës ishte shmangia e diskutimit për të kaluarën. Të tjerët pohonin se «të merresh me të kaluarën në Kosovë sot përbën një gabim sistemik sepse ajo nuk është e kaluar... ne ende jetojmë në ato procese me të cilat duhet të përballemi ... konflikti ende po vazhdon dhe fatkeqësisht jemi thellë brenda tij».[134]

Kjo përmbledhje dhe perceptim i të anketuarve tregon se nismat e TsK dhe DT në Kosovë kanë pasur ndikim të kufizuar, kryesisht sepse ka mungesë të vullnetit politik në mesin e të gjitha palëve të interesit në Kosovë dhe Serbi për t'u ballafaquar vërtet me të kaluarën. Kjo mungesë e vullnetit politik për t'u përfshirë seriozisht dhe përmes përpjekjeve të vazhdueshme për t'u përballë me të kaluarën, u manifestua përmes iniciativave ad-hoc dhe të bazuara në projekte, të cilat nuk kishin bashkëpunim dhe bashkërendim të mjaftueshëm. Vullneti politik u shfaq edhe midis liderëve politikë ndërkombëtarë dhe kombëtarë për të ndërmarrë masa efektive institucionale dhe politike për adresimin e çështjeve të trashëguara nga e kaluara. Më e rëndësishmja, nuk kishte iniciativa të mjaftueshme me viktimat dhe të mbijetuarit në qendër, që do t'i merrnin parasysh statusin socio-politik dhe situatën psikosociale e ekonomike.[135] Për më tej, nismat e TsK nuk i kanë përfshirë sa duhet aspektet gjinore të komuniteteve të prekura.[136] Në veçanti, nismat e TsK nuk janë angazhuar sa duhet me pyetjen se si çështjet e trashëguara të konfliktit – duke filluar nga dhuna seksuale gjatë konfliktit dhe skena politike e mbizotëruar nga meshkujt në Kosovën e paskonfliktit – vazhdojnë ta ndikojnë statusin socio-ekonomik, diskriminimin dhe padrejtësitë e grupeve të ndryshme identitare në Kosovë. Për rrjedhojë, Kosova deri më sot nuk ia ka dalë të merret si duhet me çështjet e trashëguara prej luftës dhe të shkojë përpara drejt një të ardhmeje më të mirë e të drejtë për të gjithë qytetarët e saj.

123. Intervista P. 30 mars 2020, Prishtinë, Kosovë

124. Intervista Q. 30 mars 2020, Prishtinë, Kosovë

125. Shih: Milica Stojanovic, 'War Criminals Prepare to Run in Serbian Elections', BIRN, 25 maj 2020. Gjendet në: https://balkaninsight.com/2020/05/26/war-criminals-prepare-to-run-in-serbian-elections/.

126. HLC, 'Fifth Report on the Implementation of the National Strategy for Prosecution of War Crimes', Beograd, Serbi, 2019, f. 7. Gjendet në: http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2019/12/Fifth_Report_on_the_Implementation_of_the_National_Strategy_for_Prosecution_of_War_Crimes.pdf.

127. Humanitarian Law Center, Fifth Report on the Implementation of the National Strategy for Prosecution of War Crimes, f. 7.

128. Humanitarian Law Center, 'Dossier: The cover-up of evidence of crimes during the war in Kosovo: THE CONCEALMENT OF BODIES OPERATION', Beograd, 31 janar 2017. Gjendet në: http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2017/01/Dosije_OPERACIJA_SKRIVANJA_TELA_eng.pdf.

129. Fokus Grupi 1, 06 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

130. Intervista D. 05 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

131. Intervista A. 02 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

132. Fokus Grupi 2, 11 mars 2020, Graçanicë, Kosovë.

133. Intervista Q. 30 mars 2020, Prishtinë, Kosovë

134. Fokus Grupi 2, 11 mars 2020, Graçanicë, Kosovë.

135. Intervista C. 03 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

136. Impunity Watch and BIRN, 'Balkan Chronicle: Gender equality, transitional justice, and the international community', Hagë e Sarajevë, 5 dhjetor 2019. Gjendet në: https://www.impunitywatch.nl/docs/PolicyBrief_Balkans_Chronicle_Gender_Equality_TJ_Intl_Community_eng.pdf.

Drejt një infrastrukture diskutuese për trajtmin e të kaluarës në Kosovë

Analiza e deritashme në studim nënvizoi nevojën për qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse ndaj drejtësisë tranzicionale në Kosovë. Ky seksion propozon një qasje me katër hapa për zhvillimin e një infrastrukture diskutuese për TsK në Kosovë. Katër hapat përfshijnë:

1 Gjenerimin e një mirëkuptimi kombëtar të informuar nga qytetarët mbi parimet dhe etikën për TsK në Kosovë;

2 Zhvillimin e një baze të integruar të njohurive dhe depozitimin e strategjive, nismave dhe mekanizmave ekzistues për sektorët specifikë të drejtësisë tranzicionale në Kosovë;

3. Zhvillimin e një strategjie kombëtare për TsK nga poshtë-lart dhe të përqendruar drejt viktimave; si dhe

4. Hartimin e një infrastrukture institucionale të integruar për TsK.

1. Vizioni Strategjik dhe Mirëkuptimi Kombëtar mbi TsK

Kosova deri më tash nuk ka arritur të gjenerojë një mirëkuptim kombëtar për trajtimin e të kaluarës. Siç tregon analiza në këtë studim, autoritetet ndërkombëtare dhe kombëtare, si dhe grupet e shoqërisë civile kanë ndjekur iniciativa vetjake të drejtësisë tranzicionale përmes nismave paralele dhe shpesh të mbivendosura, pa një vizion të përgjithshëm. Siç pohoi një i anketuar: "strategjitë janë të për t'i pasë që të dini ç'dëshironi të bëni – por ka shumë lojtarë në lojë dhe duhet të ketë njëfarë konsensusi".[137] Çelësi i një vizioni të përbashkët për drejtësinë tranzicionale është një mirëkuptim i përgjithshëm, që mandej mundëson zotim dhe përfshirje të mjaftueshme nga të gjitha palët. Siç tha një i anketuar:

> *"Ne si shtet duhet të kemi një vizion shtetëror se çfarë duhet të bëjmë me trajtimin e proceseve të kaluara. Duhet të ketë bashkërendim sepse deri më sot kemi qenë dëshmitarë të mungesës së bashkëpunimit nëpër institucione. Ka pasur edhe mbivendosje të aktiviteteve nga njerëz dhe institucione të ndryshme».*[138]

Prandaj, hapi i parë është gjenerimi i një mirëkuptimi kombëtar mbi parimet dhe etikën për trajtimin e të kaluarës dhe ndjekjen e drejtësisë tranzicionale në Kosovë. Kjo mund të marrë formën e parimeve kryesore që janë miratuar dhe zbatuar vullnetarisht nga të gjitha palët e interesuara që punojnë me këto tema/çështje në Kosovë. Këto parime dhe etika duhet të informohen nga preferencat e qytetarëve dhe gjithashtu të mbështeten nga liderët politikë. Siç theksuan shumica e të anketuarve, çelësi për një qasje të qëndrueshme ndaj drejtësisë tranzicionale në Kosovë është promovimi i tri elementeve: 1) përparësia e qasjes së përqendruar te viktimat dhe të mbijetuarit; 2) barazi dhe ndjeshmëri më e madhe gjinore; dhe 3) deetnizimi, depolitizimi dhe depersonalizimi i nismave të TsK. Siç pohoi një i anketuar:

> *«Politikanët nuk duhet të jenë aktorët kryesorë në nismat e drejtësisë Tranzicionale dhe bisedat me viktimat, do të ishte më mirë me pasë ekspertë, njerëz që kanë humbur të vetët në luftë, sepse ata janë më të pranueshëm për të gjitha audiencat dhe më të besueshëm. Politikanët mund të kenë një rol, por nuk është gjë me mend me pasë politikanë që duken në trajtimin e nismave të të kaluarës».*[139]

Ndër nismat ekzistuese ka pasur përpjekje për të përfshirë palët e interesuara në gjenerimin e një vizioni dhe të parimeve të përbashkëta për t'u marrë me të kaluarën. Prandaj, tashmë ekziston një bazë dhe vetëdije për rëndësinë e përfshirjes së qytetarëve e cila duhet të kapitalizohet dhe të zhvillohet mirëfilli. Për shembull, ekziston një iniciativë e vazhdueshme e shoqërisë civile, e përkrahur nga Ambasada Zvicerane në Kosovë, për të zhvilluar një varg parimesh që udhëheqin punën e institucioneve dhe OJQ-ve kur merren me të kaluarën dhe komunitetet e prekura.[140] Kjo nismë ka për qëllim të zhvillojë parime për trajtimin e së kaluarës në Kosovë që ta informojnë dhe ta udhëheqin punën e përfaqësuesve politikë, e të politikëbërësve se «si të përfshihen me viktimat, të mbijetuarit, ngjarjet e kaluara dhe narracionet historike» si dhe «si të parandalojnë ligjërimin

137. Intervista L. 25 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

138. Intervista P. 30 mars 2020, Prishtinë, Kosovë

139. Intervista R. 31 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

140. Intervista B. 03 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

e dëmshëm dhe veprimet që lidhen me çështjet e trashëguara prej konfliktit».[141] Ndër parimet e propozuara, është njohja e integritetit dhe dinjitetit të viktimave dhe të mbijetuarve, dhe përfshirja më e madhe, më e barabartë dhe më e drejtë e tyre në të gjitha nismat e drejtësisë tranzicionale. Në këtë dokument ka edhe një njohje të rëndësisë së dimensioneve gjinore dhe shmangie të madhërimit të të akuzuarve ose të të dënuarve për krime të luftës, shmangie të gjuhës së urrejtjes dhe të atribuimit kolektiv të veprave të liga, si dhe më shumë prova të bazuara në raportime etike, duke përfshirë mbrojtjen e identitetit të dëshmitarëve.

Ndërsa nisma e lartpërmendur për të hartuar parimet për trajtimin e të kaluarës ofron bazë solide për një angazhim normativ dhe etik në temën e trajtimit të së kaluarës, ajo duhet të sigurojë angazhim dhe pronësi më të gjerë popullore dhe politike për të siguruar një legjitimitet më të gjerë dhe konsensus midis të gjitha segmenteve të shoqërisë. Zhvillimi i parimeve dhe etikës për drejtësinë tranzicionale duhet të bëhet përmes një procesi të gjerë këshillues me të gjitha segmentet e shoqërisë. Këto parime duhen hartuar me një gjuhë të kuptueshme dhe të informuar nga grupet dhe komunitetet lokale të viktimave. Këto parime dhe ajo etikë që formojnë vizionin strategjik mbi TsK, mund të gjenerohen me këshillime diskutuese nga poshtë-lart dhe hulumtime të veprimeve pjesëmarrëse që përfshijnë një gamë të gjerë qytetarësh, të shoqëruar me angazhimin e ekspertëve përkatës dhe të politikëbërësve. Pastaj, duhet të ketë një fushatë gjithëpërfshirëse për miratimin e këtij vizioni strategjik nga të gjithë aktorët përkatës, të shoqëruar me një mekanizëm përkatës për ndjekjen dhe monitorimin e pajtueshmërisë dhe respektimit të parimeve dhe etikës për drejtësinë tranzicionale në Kosovë. Parimet mbi drejtësinë tranzicionale duhet të përfshijnë edhe perspektivat e komuniteteve pakicë për të siguruar një legjitimitet dhe pranim më të gjerë. Të anketuarit serbë të Kosovës kanë theksuar shqetësimin që çdo iniciativë e ardhur nga institucionet e Kosovës, pavarësisht sa e mirë është, nuk pranohet lehtë.[142] Prandaj, më shumë metoda pjesëmarrëse e gjithëpërfshirëse për hartimin e këtyre parimeve mund t'i kapërcejnë zgjidhjet e modeleve nga lart-poshtë, të hartuara nga jasht, të cilat nuk përshtaten me nevojat dhe interesat specifike të të gjitha grupeve etnike në Kosovë.

2. Depozitë e njohurive mbi drejtësinë tranzicionale

Edhe pse ka pasur nisma të shumta krah për krah për drejtësi tranzicionale në Kosovë, nuk ka një vend qendror ku të ruhen të gjitha njohuritë dhe të dhënat për këtë temë. Një numër i të anketuarve kanë theksuar se mungesa e një baze të integruar të njohurive mbi drejtësinë tranzicionale në Kosovë ka minuar perspektivat për lidhjen më të mirë të nismave ekzistuese dhe shmangien e mbivendosjeve.[143] Donatorët shpesh përfundonin duke mbështetë nisma të ngjashme pa shumë kosto-efektivitet dhe harmonizim me nismat ekzistuese.[144] Kemi vërejtur edhe se në mesin e të anketuarve ka mungesë njohurish ose boshllëqe në sa ata dinë për nismat e tjera që vijonin. Kështu, një depozitë qendrore e njohurive mbi drejtësinë tranzicionale do të ishte thelbësore jo vetëm për dokumentimin e punës së mekanizmave dhe të iniciativave ekzistuese, por edhe për t'u siguruar që hartimi i politikave të informohet nga të dhëna dhe njohuri në dispozicion të publikut. Kjo depozitë mund të përmbajë informacione mbi ligjet, raportet dhe të dhënat

141. 'Principles on Dealing with the Past for the Kosovo Context', draft dokument i brendshëm, maj 2020.

142. Intervista Q. 30 mars 2020, Prishtinë, Kosovë

143. Intervista S. 01 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

144. Intervista G. 10 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

statistikore të institucioneve shtetërore, çështje gjyqësore, raporte dhe studime të prodhuara nga think-tanket, OJQ-të dhe hulumtimet e tjera nga komuniteti akademik, si dhe të dhëna e informacione të tjera në dispozicion të publikut për drejtësinë tranzicionale në Kosovë e më gjerë. Kjo depozitë mund të përmbajë edhe histori gojore, rrëfime nga qytetarët, dhe përmbajtje të tjera të padokumentuara dhe të padëgjuara audio-vizuale që kapin përvojat dhe vuajtjet, si dhe mëkëmbjen e të gjitha grupeve etnike në Kosovë.

Tashmë ka sasi të madhe dokumentesh të mbledhura nga mekanizma të ndryshëm qeveritarë dhe OJQ, të cilat duhen grumbulluar në një depozitë kolektive. Për shembull, zyra e Fondit për të Drejtën Humanitare në Kosovë, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, baza e të dhënave e KMLDNj, si dhe Qendra Burimore për Persona të Zhdukur i kanë bibliotekat e veta dhe depozitat e burimeve, që mund të grumbullohen në një bazë të njohurive të centralizuara, ndërvepruese dhe të qasshme. Në epokën digjitale, kjo depozitë mund të marrë formën e një baze digjitale të njohurive të disponueshme për të gjithë qytetarët dhe komunitetet e prekura në të gjitha gjuhët zyrtare në Kosovë. Natyrisht, qëndrueshmëria dhe jetëgjatësia e kësaj depozite kërkon mbështetje financiare dhe mbështetje të fortë institucionale, si dhe menaxhim nga një autoritet i përshtatshëm dhe i pavarur politikisht.

3. Zhvillimi i një strategjie kombëtare për TsK nga poshtë-lart dhe të përqendruar drejt viktimave

Analiza në këtë studim gjen se njëra nga arsyet kryesore pse përpjekjet për trajtimin e të kaluarës në Kosovë kanë pasur ndikim të kufizuar është se kishte mungesë vizioni strategjik dhe kornize gjithëpërfshirëse për të udhëhequr punën e institucioneve shtetërore dhe të OJQ-ve, si dhe mungesë të përfshirjes së përpjekjeve të ndërmarra nga grupet e viktimave. Një mori kritikash mbi mangësitë e nismave të kaluara i referohen dështimit për të zhvilluar një strategji kombëtare për drejtësinë tranzicionale dhe mbizotërimit të nismave e të projekteve krah për krah, pa bashkërendim, harmonizim a largpamësi. Prandaj, rëndësia e hartimit të një strategjie kombëtare për drejtësinë tranzicionale njihet gjerësisht në mesin e të anketuarve të këtij studimi. Siç deklaroi një zyrtar:

> *"Kosova duhet të ketë strategji kombëtare për drejtësinë tranzicionale, sepse ky është proces i gjatë dhe kompleks, dhe strategjia ndihmon në krijimin e një vizioni për institucionet publike. Në fund, që strategjia të ketë sukses, ajo duhet të udhëhiqet nga institucionet publike".*[145]

Në mesin e të anketuarve të këtij studimi ka konsensus të gjerë se strategjia kombëtare duhet të integrojë katër shtyllat e përkufizuara gjerësisht të drejtësisë tranzicionale, pra: gjykimet e krimeve të luftës, kërkimin e të vërtetës, dëmshpërblimet dhe garancitë e mospërsëritjes dhe reformat institucionale. Më e rëndësishmja, të anketuarit theksuan rëndësinë e hartimit të një strategjie kombëtare e cila informohet nga nevojat dhe interesat e qytetarëve dhe që rrjedh nga një proces diskutues, gjithëpërfshirës dhe nga poshtë-lart.

Deri më tash, nismat e TsK janë marrë më së shumti nga jashtë, ku konsultimi me një grup të

145. Intervista T. 21 prill 2020, Prishtinë, Kosovë.

vogël të OJQ-ve është parë si i mjaftueshëm për t'i quajtur ato pjesëmarrëse dhe të drejtuar prej qytetarëve. Analiza në këtë studim ka nxjerrë në pah premtimet dhe rreziqet e politikës përfaqësuese në kontekstin e drejtësisë tranzicionale. Duke vepruar vetëm përmes grupeve përfaqësuese, siç janë partitë politike, organizatat e shoqërisë civile dhe shoqatat e komuniteteve të prekura, ka rrezik që të anashkalohen nevojat dhe interesat e viktimave dhe të mbijetuarve të konfliktit që vijnë nga të gjitha identitetet dhe prejardhjet gjeografike. Shpesh nismat e bazuara në projekt janë hartuar rreth projekteve afatshkurtra dhe me kohë të caktuar, që rrezikojnë t'i anashkalojnë proceset pjesëmarrëse dhe rëndësinë e legjitimitetit e të pronësisë nga përfituesi dhe komunitetet e prekura. Prandaj, duket e përshtatshme të sugjerohet se përpjekjet e ardhshme për t'u marrë me të kaluarën duhet të eksplorojnë qasjet diskutuese të cilat përfshijnë qytetarët dhe komunitetet e prekura drejtpërdrejt dhe shmangin polarizimin e përjashtimin e dalë nga strukturat përfaqësuese.[146] Procesi se si hartohen strategjitë, korniza parimesh dhe veprimesh, është po aq i rëndësishëm sa mekanizmat dhe rezultatet pasuese.

Duke marrë parasysh këto çështje, diskutimet demokratike shqyrtuese për trajtimin e të kaluarës si qasje alternative mund të ofrojnë bazë më të mirë për të përcaktuar se cilat nga çështjet e trashëguara do të trajohen. Drejtësia tranzicionale e diskutuar rrit mundësitë për më shumë reciprocitet midis shtetit dhe aktorëve joshtetërorë si dhe komuniteteve të prekura, pasi ka gjasa më të mëdha për përgjegjësi publike si dhe një ndjenjë të barazisë, të kujdesit dhe të përgjegjësisë. Siç thotë Colleen Murphy, studiues i drejtësisë tranzicionale: «Demokracia është komponent i domosdoshëm i drejtësisë tranzicionale, sepse është e nevojshme që marrëdhëniet të jenë marrëdhënie mes të barabartëve».[147] Kjo nënkupton mundësinë që qytetarët të hartojnë vetë nisma të drejtësisë tranzicionale, që i njohin zërat e komuniteteve të prekura dhe u japin ndjenjën se ka pasur një masë drejtësie për njohjen e vuajtjeve të të kaluarës. Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut gjithashtu njohu përfitimet e proceseve nga poshtë-lart dhe të konsultimeve kombëtare, pasi ato luajnë një rol vendimtar në:

> *«Përcaktimin e rolit më të mirë zyrtar për viktimat, duke theksuar përvojën e grupeve të viktimave përndryshe të lëna pas dore, identifikimin e mekanizmave kulturorë të përshtatshëm për ta treguar të vërtetën, përcaktimin e rolit në procedurat e praktikave kulturore, përcaktimin e elementeve për një strategji të ndjekjes penale, rregullimin e procedurave të papërshtatshme, vendosjen e periudhës kohore që do të mbulohet nga mekanizma të ndryshëm të drejtësisë tranzicionale dhe si më së miri të hartohen rekomandimet për çështjet si dëmshpërblimi".[148]*

Drejtësia e diskutueshme tranzicionale në këtë kontekst përfshin ridizajnimin e mënyrës se si u duhet qasë nevojave dhe shqetësimeve të komuniteteve të prekura, përpara se të përkthehen në dokument politikash dhe të zhvillohet një mekanizëm institucional. Kjo përfshin ndërveprime të drejtpërdrejta publike me komunitetet e prekura përmes tubimeve në komunitet dhe atyre lokale, kuvendeve të qytetarëve, përkujtimeve e përcaktuara dhe proceseve të vendimmarrjes me viktimat në qendër, para se imponimet nga donatorët, institucionet shtetërore ose OJQ-të. Siç pohoi një aktivist i shoqërisë civile:

> *«Nëse duam të kemi një proces të drejtë dhe të kemi sukses pronësinë lokale nga poshtë-lart, është me rëndësi të punojmë me njerëzit në nivelin lokal dhe t'i përfshijmë ata në proces. Ata duhet të jenë më transparentë dhe të përfshijnë më shumë njerëz, të kenë bazë më të gjerë dhe të shkojnë në zona të largëta, të takojnë më shumë njerëz, sepse kjo është gjithçka».149*

Drejtësia tranzicionale e diskutuar kontribuon në hartimin e projekteve dhe të ndërhyrjeve që janë të përshtatshme kulturalisht dhe i përshtaten kontekstit dhe nevojave të komuniteteve të prekura, që mund të ndryshojnë nga një rajon në tjetrin. Qasjet diskutuese dhe nga poshtë-lart shihen si më të përshtatshme për vendosjen e komuniteteve të prekura në qendër të procesit të drejtësisë tranzicionale dhe ua njohin të drejtën për t'u këshilluar. Siç deklaroi një i anketuar:

> *"Trajtimi i së kaluarës duhet të jetë proces gjithëpërfshirës, jo veç i institucioneve, me pjesëmarrje të mjaftueshme nga të gjithë aktorët, por sidomos nga të mbijetuarit. Procesi duhet të jetë me fokus në viktima kështu do të sigurojmë edhe pronësinë nga viktimat/të mbijetuarit ndaj procesit».150*

Në praktikë, pjesëmarrja domethënëse e komuniteteve të prekura në nismat e TsK kërkon jo veç pjesëmarrje instrumentale përmes dëshmisë si dëshmitarë në gjykimet në gjykatat e krimeve të luftës dhe hetimet e kërkimit të të vërtetës; ose pjesëmarrje përfaqësuese përmes shoqatave, rrjeteve dhe organizatave të komuniteteve të prekura që luajnë rol në formimin e politikave dhe të aspekteve institucionale të TsK. Më e rëndësishmja, kërkon përfaqësim transformativ përmes përfshirjes së drejtpërdrejtë të komuniteteve të prekura në diskutimet lokale dhe konsultimet kombëtare për hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e strategjive dhe aktiviteteve të TsK.[151] Prandaj, që një drejtësi tranzicionale e mirëfilltë nga poshtë-lart dhe pjesëmarrëse të zhvillohet e të jetë transformative, komunitetet e prekura lokale – që përfaqësojnë familjet e viktimave, të mbijetuarit, veteranët e luftës dhe kategoritë e tjera – duhet të fuqizohen, të formësojnë dhe t'i drejtojnë të gjitha fazat e procesit. Një i anketuar pohoi se «çelësi i një strategjie të suksesshme është përfaqësimi dhe gjithëpërfshirja».[152] Pjesëmarrja e komuniteteve të prekura në të gjitha këto faza mandej «bëhet element kryesor i fuqizimit që sheh se të margjinalizuarit sfidojnë, i qasen dhe i formësojnë institucionet dhe strukturat nga të cilat ishin përjashtuar më parë».[153] Një konsultim

146. Patricia Lundy dhe Mark McG qeveris, 'Whose Justice? Rethinking Transitional Justice from the Bottom Up', Journal of Law and Society, Vol. 35, Nr. 2, p. 266. Shih edhe: Roger Duthie dhe Paul Seils. 'Justice Mosaics. How Context Shapes Transitional Justice in Fractured Societies". New York: International Centre for Transitional Justice, 2017.

147. Colleen Murphy, 'Deliberative Democracy and Agency'. N'Whose Justice? L. Keleher dhe S. J. Kosko (eds) Agency and Democracy in Development Ethics, Cambridge: Cambridge University Press, 2009, f. 359.

148. Office of the UN High Commissioner for Human Rights, 'National consultations on transitional justice', f. 2.

149. Intervista B. 03 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

150. Po aty.

151. Për një diskutim më të gjerë dhe krahasues mbi shkallët e pjesëmarrjes, shihni: Kora Andrieu, et al., 'To participate is to have hope: Victim participation in Tunisia's transitional justice process', Tunis: Transitional Justice Barometer, 2015.

152. Intervista D. 05 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

153. Paul Gready and Simon Robins, 'From Transitional to Transformative Justice: A New Agenda for Practice', The International Journal of Transitional Justice, Vol. 8, Nr. 3, 2014, p. 358.

i kujdesshëm sigurohet që të prekurit nga konflikti të dëgjohen, ashtu që programet e drejtësisë tranzicionale të pasqyrojnë më së miri përvojat, nevojat dhe të drejtat e tyre. Siç deklaroi një i anketuar:

> *«Konsultimet publike mund të ndihmojnë në sigurimin e gjithëpërfshirjes... Njerëzit do të dinë më së miri ç'të bëjnë për vetveten, kjo është arsyeja pse mendoj që do të ishte me rëndësi të edukohen njerëzit në nivelin lokal».154*

Ndonëse qasjet diskutuese për hartimin e nismave të drejtësisë tranzicionale në Kosovë mund të gëzojnë legjitimitet më të gjerë, ato rrezikojnë të ndryhen nga dinamikat politike kombëtare. Për shembull, në mesin e komunitetit serb të Kosovës, njihet mirë rëndësia e qasjeve nga poshtë-lart dhe të drejtuara nga qytetarët për hartimin e strategjive për drejtësinë tranzicionale. Siç pohoi një i anketuar: «Mendoj se do të ishte e drejtë me pasë një qasje nga poshtë-lart për një strategji kombëtare, mendoj se metodologjikisht nuk do të ishte problem, por problemi vjen kur kjo të bëhet politike».[155] Sidoqoftë, ka shqetësime se pa agjenci dhe përfaqësim të duhur politik në nivelin politik, komunitetet pakicë mund të tejkalohen numerikisht dhe të margjinalizohen nga shqetësimet e mazhorancës dhe ankesat e tyre për vuajtjet dhe humbjet gjatë konfliktit.[156]

4. Drejt një infrastrukture institucionale për trajtimin e së kaluarës

Më në fund, nëse Kosova arrin të zhvillojë një konsensus kombëtar mbi parimet udhëzuese për drejtësinë tranzicionale, e zhvillon një depozitë gjithëpërfshirëse të njohurive dhe gjeneron një strategji përmes metodave diskutuese, do t'i kishte përbërësit dhe mjetet e nevojshme për zhvillimin e një infrastrukture institucionale ombrellë për TsK, e cila do të ishte përgjegjëse për mbështetjen e iniciativave ekzistuese dhe të ardhshme për t'u marrë me të kaluarën në Kosovë. Domosdoja për një infrastrukturë për drejtësi tranzicionale në Kosovë vjen nga të kuptuarit se mbështetja në mekanizma jofunksionalë dhe në iniciativat e mbivendosura ad-hoc e të bazuara në projekte, i rrënon objektivat e drejtësisë tranzicionale dhe rezulton në rezultate joefektive e të pasigurta. Koncepti i infrastrukturës për TsK nënkupton zhvillimin dhe bashkërendimin e strukturave institucionale dhe joqeveritare, nismave dhe burimeve që promovojnë drejtësinë tranzicionale në Kosovë.[157] Me fjalë të tjera, nënkupton angazhimin e të gjitha niveleve të shoqërisë dhe lidhjen e të gjitha strukturave ekzistuese e të ardhshme, të mekanizmave, iniciativave dhe burimeve, për t'u marrë me të kaluarën. Një infrastrukturë e përcaktuar posaçërisht për TsK do t'u jepte njerëzve një adresë ku ata dinë se mund të kërkojnë drejtësi për të kaluarën.
Dizajni i infrastrukturës së ardhshme për TsK duhet të jetë para së gjithash në shërbim të zbatimit të vizionit strategjik dhe të kornizës për drejtësinë tranzicionale, si dhe të bëhet organ i mirëfilltë që punon për komunitetet e prekura dhe sigurohet që interesat e tyre të avancohen përmes kërkimit të të vërtetës, drejtësisë, kompensimit, etj. dhe garanton mospërsëritjen. Infrastruktura në të ardhmen për TsK duhet të miratojë metoda diskutuese, përfshirëse dhe transparente të vendimmarrjes, që pasqyrojnë shqetësimet dhe nevojat e komuniteteve të prekura, e që i përkasin të gjitha grupeve sociale e etnike të shoqërisë kosovare. Ai duhet të jetë i hapur për ta transformuar mandatin e vet dhe fushëveprimin e aktiviteteve, varësisht nga sa përparim bën Kosova në shpalosjen e të vërtetës dhe promovimin e përkujtimit gjithëpërfshirës, sjelljen e kriminelëve para drejtësisë, mbrojtjen e viktimave dhe të mbijetuarve, si dhe ndërmarrjen e reformave institucionale. Infrastruktura për TsK mund të ketë këto funksione:

- Të shërbejë si organ lidhës për iniciativat ekzistuese të drejtësisë tranzicionale përmes shkëmbimit të informacionit dhe takimeve të rregullta këshilluese;
- Të angazhohet në çështje interaktive, bashkëpunuese dhe diskutuese për zgjidhjen e problemeve lidhur me TsK;
- Të ofrojë një hapësirë për komunitetet e prekura që të kanalizojnë nevojat dhe të lobojnë për të drejtat e interesat e tyre;
- Të ofrojë shërbime këshilluese dhe konsultime për të gjitha komunitetet e prekura dhe palët e interesuara përkatëse;
- Të ndjekë zbatimin e strategjisë kombëtare për drejtësinë tranzicionale dhe pajtueshmërinë e institucioneve shtetërore, organizatave joqeveritare, mediave dhe organeve të tjera me parimet e drejtësisë tranzicionale;
- Të shërbejë si platformë për prodhimin, shpërndarjen dhe dokumentimin e njohurive mbi drejtësinë tranzicionale përmes hulumtimeve analitike dhe empirike, punëtorive trajnuese dhe aktiviteteve promovuese;
- Të lidhë proceset e drejtësisë tranzicionale me ndërtimin e paqes dhe aktivitete të tjera të zhvillimit të qëndrueshëm për të promovuar paqen, drejtësinë dhe një të ardhme të përbashkët.

Këto funksione do ta kthenin infrastrukturën për TsK në strukturë dinamike, e cila siguron përshtatjen në kontekstin kombëtar, promovon pronësinë e procesit nga të gjitha komunitetet e prekura dhe palët e interesuara përkatëse dhe ndërlidh të gjitha elementet e drejtësisë tranzicionale.

Infrastruktura për TsK duhet të krijojë hapësirë për organizata dhe grupe të ndryshme në nivelin lokal, komunal dhe kombëtar. Me fjalë të tjera, infrastruktura për drejtësi tranzicionale duhet të themelohet në të gjitha nivelet shoqërore: me integrim vertikal midis nivelit lokal, komunal, rajonal dhe kombëtar; si dhe integrim horizontal të të gjithë mekanizmave dhe nismave qeveritare e joqeveritare.[158] Në dizajnimin e ardhshëm të një infrastrukture për drejtësi tranzicionale në Kosovë,

154. Intervista C. 03 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

155. Intervista Q. 30 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

156. Shih për shembull: Alternative Dispute Resolution Center, 'Can we understand one another?', Mitrovica, nëntor 2018. Gjendet në: http://mediation-mitrovica.org/wp-content/uploads/2019/02/POR-Can-we-understand-one-another-ENG.pdf.

157. Ky koncpet bazohet në një infrastrukturë tashmë e mirëpërcaktuar për paqen në vende të ndryshme të prekura nga konfliktet. Shih për shembull: Paul van Tongeren, et al. 'The Evolving Landscape of Infrastructures for Peace, Journal of Peacebuilding & Development, Vol. 7, No. 3, 2012, pp.1-7; Hans J. Giessmann, Embedded peace: Infrastructures for Peace – Approaches and Lessons Learned, Berlin: Berghof Foundation, 2016. Gjendet në:https://www.undp.org/content/undp/en/home/librarypage/democratic-governance/conflict-prevention/infrastructures-for-peace--approaches-and-lessons-learned.html.

158. Intervista G. 10 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

komuniteti ndërkombëtar duhet ta ripërcaktojë rolin e vet.[159] Ndërsa disa të anketuar besojnë se bashkësia ndërkombëtare dhe donatorët janë partnerë më të mirëfilltë sesa autoritetet shtetërore kur merren me të kaluarën, të tjerët e shohin përfshirjen e aktorëve të jashtëm me një dozë skepticizmi, kryesisht për shkak të suksesit të kufizuar në dy dekadat e fundit.[160] Prandaj, komuniteti i donatorëve do të përfitonte nga shpërndarja e ndihmës për ata mekanizma dhe iniciativa që adresojnë nevojat dhe interesat e komuniteteve të prekura në Kosovë dhe sigurojnë qëndrueshmëri në vend se të ndjekin agjendat e dizajnuara jashtë që shpesh kodifikojnë interesa gjeopolitikë. Shkurt, mbështetja e jashtme për drejtësinë tranzicionale duhet të udhëhiqet nga nevojat lokale dhe të përshtatet me kontekstin lokal. Palët e interesuara ndërkombëtare dhe kombëtare në Kosovë, të preokupuara me qëllime afatshkurtra, nuk ishin në gjendje të zhvillonin mekanizma efektivë dhe afatgjatë për t'u marrë me të kaluarën. Sidoqoftë, shumica e të anketuarve kanë theksuar se institucionet shtetërore duhet të kenë përgjegjësinë parësore për t'u marrë me të kaluarën dhe për të ndjekur drejtësinë tranzicionale në Kosovë. Me këtë parasysh, janë dy mundësi reale për hartimin e infrastrukturës për drejtësi tranzicionale në Kosovë.

Mundësia e parë mund të jetë Departamenti i sapokrijuar për Drejtësi Tranzicionale dhe Mbështetje të Viktimave të Krimit në Ministrinë e Drejtësisë, i cili mund të shërbejë si infrastrukturë institucionale për drejtësi tranzicionale në Kosovë. Ky departament tashmë ka mandat ligjor që mbulon një gamë të gjerë aspektesh të drejtësisë tranzicionale, duke përfshirë aftësinë që: 1) të propozojë politika dhe akte normative që lidhen me fushën e drejtësisë tranzicionale; 2) të sigurojë mbështetje në mbledhjen dhe dokumentimin e fakteve që lidhen me krimet e luftës; 3) të ofrojë mbështetje për identifikimin, dokumentimin dhe vlerësimin e dëmeve të luftës; 4) të propozojë politika dhe akte normative për statusin dhe trajtimin e viktimave të luftës; 5) të mbështesë bashkëpunimin dhe bashkërendimin e institucioneve në fushën e krimeve të luftës brenda kompetencës së Ministrisë së Drejtësisë; dhe 6) të shqyrtojë kërkesat e kompensimit të viktimave të krimit, ndër funksione të tjera.[161] Ky departament mund të funksionojë si institucion ombrellë që do të synonte bashkërendim dhe bashkëpunim më të mirë midis të gjithë aktorëve përkatës. Departamenti duhet të sigurojë harmonizimin midis nismave të ndryshme dhe të shmangë mbivendosjet në ndihmën e donatorëve. Nëse drejtohet siç duhet, departamenti duhet të përfaqësojë interesat dhe nevojat e komuniteteve të prekura. Megjithatë, ekziston rreziku që ky departament të politizohet dhe të jetë i paaftë për të zbatuar mandatin, sepse është institucion qeveritar, siç kemi parë në të kaluarën me Institutin për Hulumtime të Krimeve të Luftës dhe GPNM-TKP.

Mundësia e dytë është krijimi i një agjencie të pavarur, të mbështetur nga shteti, të përkushtuar vetëm për bashkërendimin, dokumentimin, monitorimin dhe mbështetjen e të gjitha nismave ekzistuese dhe të ardhshme për t'u marrë me të kaluarën në Kosovë. Mund të emërtohet si 'Agjencia e Kosovës për Trajtimin e të Kaluarës'. Kjo agjenci e re do të kishte përbërje dhe strukturë të ngjashme si agjencitë e tjera shtetërore të pavarura në Kosovë, si Institucioni i Ombudspersonit, Agjencia për Barazi Gjinore, Agjencia Antikorrupsion dhe mekanizma të ndryshëm rregullatorë. Disa prej agjencive shtetërore të pavarura dhe gjysmë të pavarura janë themeluar nga Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës dhe kanë buxhet të caktuar shtetëror si dhe mbështetje administrative. Krijimi i infrastrukturës së ardhshme për TsK mund të mbështetet veçmas nga aktivizmi i grave

159. Intervista L. 25 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

160. Intervista E. 10 mars 2020, Prishtinë, Kosovë. Konsultim me grupin e shoqërisë civile në Kosovë, 20 maj 2020, online.

161. Qeveria e Kosovës, 'Rregullorja GRK – Nr.12 / 2018 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores GRK-Nr. 31/2013 për Organizatën e Brendshme të Ministrisë së Drejtësisë ', Prishtinë, 2018. Gjendet në: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17792.

në Kosovë dhe suksesi i tyre në avancimin e barazisë gjinore në nivelin politik institucional dhe shoqëror në Kosovë.[162] Përparësia e opsionit të dytë është të sigurojë pavarësi më të madhe nga qeveria dhe institucionet e tjera politike, të cilat deri tani kanë mbizotëruar skenën e drejtësisë tranzicionale, por nuk kanë arritur të japin rezultatet e pritura. Ai do të mundësonte edhe rol më të madh për Kuvendin e Kosovës, i identifikuar nga të anketuarit si aktor thelbësor për demokratizimin e drejtësisë tranzicionale.[163] Për më tej, kjo agjenci e re mund të jetë më e pranueshme për komunitetet pakicë[164] si dhe donatorët ndërkombëtarë. Do të kishte më shumë hapësirë për të dizajnuar këtë institucion në përputhje me nevojat e komuniteteve të prekura dhe bashkësisë së organizatave dhe të shoqatave që punojnë për drejtësi tranzicionale.

Pavarësisht se cila mundësi do të ishte më e zbatueshme, ekzistojnë shqetësime legjitime nëse infrastruktura për t'u marrë me të kaluarën do të funksiononte më së miri nëse do të drejtohej nga institucionet shtetërore, dhe në veçanti si do të adresohej problemi i financimit prej shtetit dhe varësia nga vullneti politik i udhëheqësve kryesorë politikë. Nismat lokale dhe veçmas ato të drejtuara nga OJQ-të nuk mund të kenë sukses pa angazhimin politik të liderëve kombëtarë. Sidoqoftë, këto dilema mund të zgjidhen nëse ka unitet të qëllimit midis komuniteteve të prekura dhe avokim të fortë nga grupet e shoqërisë civile e donatorët, dhe nëse punohet me të gjitha partitë politike në Kosovë dhe me elektoratet e tyre.

Përvoja e fundit e Tunizisë ofron shembull nga i cili Kosova mund të mësojë. Në Tunizi, pas revolucionit dhe ndryshimit të regjimit më 2011, qeveria e re themeloi Ministrinë e të Drejtave të Njeriut dhe të Drejtësisë Tranzicionale, e cila ngarkohej me ndërmarrjen e një konsultimi kombëtar për drejtësinë tranzicionale, që të përcaktonte një strategji gjithëpërfshirëse të drejtësisë tranzicionale për vendin. Një komitet teknik i përbërë nga përfaqësues të qeverisë dhe organizata të shoqërisë civile ndërmori një dialog të gjerë kombëtar dhe konsultime rajonale përpara hartimit të ligjit për drejtësinë tranzicionale. Para bashkëveprimit me komunitete të ndryshme të prekura dhe anketimit të pikëpamjeve të tyre, u organizua një fushatë kombëtare vetëdijesimi për ta përmirësuar mirëkuptimin e procesit konsultativ.[165] Procesi konsultativ rezultoi me adaptimin e Ligjit Organik për Drejtësinë tranzicionale dhe krijimin e Komisionit të të Vërtetës dhe të Dinjitetit. Sidoqoftë, procesi i konsultimit kombëtar kishte mangësi që u reflektuan në ligjin e fundit Organik dhe përpjekjet pasuese të drejtësisë tranzicionale. Përfshirja e procesit të drejtësisë tranzicionale të Tunizisë në një ministri qeveritare çoi në shkëputjen e disa segmenteve të shoqërisë civile nga ky proces, sepse e perceptonin si projekt politik të shtyrë nga qeveria e re në vend se të pasqyronte kërkesat nga poshtë.[166]

Për më tej, dialogu kombëtar ishte dizajnuar në përputhje me përvojat ndërkombëtare dhe njohuritë e drejtësisë tranzicionale. Drejtësia shoqërore dhe kërkesat e dinjitetit të revolucionit përqendroheshin rreth qasjes në punë, papunësisë dhe pabarazisë. Këto shqetësime lokale u shuan në të mirë të kategorive të përcaktuara ndërkombëtarisht dhe të paracaktuara që përqendroheshin në shkeljet e të drejtave civile dhe politike siç janë abuzimet prej policisë dhe shkeljet e procesit

162. Konsultim me grupin e shoqërisë civile në Kosovë, 20 maj 2020, online.

163. Intervista A. 02 mars 2020, Prishtinë, Kosovë.

164. Konsultim me grupin e shoqërisë civile në Kosovë, 20 maj 2020, online

165. Christopher K. Lamont dhe Héla Boujneh. 'Transitional justice in Tunisia: Negotiating justice during transition', Politička misao: časopis za politologiju, Vol. 49, No. 5, 2012, f. 32-49.

166. Lamont dhe Boujneh, 'Transitional justice in Tunisia: Negotiating justice during transition'.

të nevojshëm.[167] Për më tej, përtej dialogut kombëtar, procesi i drejtësisë tranzicionale tuniziane u qortua pse ishte më pak përfshirës sesa shpallte. Pjesëmarrja ishte e qartë gjatë dialogut kombëtar dhe hartimit të ligjit për drejtësinë tranzicionale, por vetë ligji organik dështoi të përfshijë shumë kërkesa të popullatave më të margjinalizuara dhe të përjashtuara, siç janë gratë në zonat rurale.[168] Përtej problemeve që rrënojnë procesin nga poshtë-lart, mosmarrëveshjet politike midis palëve që përfaqësojnë regjimin e vjetër dhe të riun, të shoqëruar me pretendime për korrupsion dhe keqmenaxhim nga Komisioni i së Vërtetës dhe Dinjitetit, rrënuan më tej operacionalizimin dhe zbatimin e ligjit për drejtësinë tranzicionale.

167. Po aty.

168. Paul Gready, 'A transitional justice barometer: Measuring the needs for and impact of transitional justice processes in Tunisia, 2016, Netherlands Organisation for Scientific Research (NWO). Gjendet në: https://www.nwo.nl/en/research-and-results/research-projects/i/07/12607.html.

Përfundim: Reflektime përtej Kosovës

Çdo konflikt i dhunshëm është i veçantë në tiparet e tij. Dhe kështu janë edhe nevojat dhe dinamika e drejtësisë tranzicionale. Çështjet e trashëguara të konfliktit të dhunshëm në Kosovë janë adresuar vetëm pjesërisht deri më sot.

Vetëm një pjesë e vogël e gjykimeve për krime lufte janë zhvilluar përmes gjykatave ndërkombëtare, hibride e kombëtare. Një numër i madh i kryesve të dyshuar të krimeve janë të lirë, ndërsa viktimat dhe të mbijetuarit vazhdojnë të gjakojnë për masa të të vërtetës, drejtësi, njohje dhe përmbyllje. Mekanizmat qeveritarë për TsK në Kosovë janë përpjekur t'u përgjigjen me gjysmë zemre nevojave dhe të drejtave të komuniteteve të prekura, por mungesa e vullnetit politik, e shoqëruar me kapacitete dhe burime të dobëta institucionale dhe me politizimin e atyre nismave, ka pasur pak ose aspak ndikim në avancimin e të vërtetës, të drejtësisë dhe pajtimit në Kosovë. Për më keq, kjo situatë përjetëson imazhet e armikut dhe ndjenjat etno-nacionaliste, që mund të bëhen terren për ripërtëritjen e konflikteve. Nismat e tjera, të drejtuara nga organet joqeveritare, janë përpjekur t'i kompensojnë këto dobësi institucionale. Megjithatë, pa një infrastrukturë të duhur institucionale për TsK, këto nisma të bazuara në projekte dhe të shkapërderdhura, kanë pasur ndikim të kufizuar. Shpresa e vetme për t'i korrigjuar këto mangësi është krijimi i një vizioni strategjik dhe konsensusi kombëtar për TsK, të shoqëruar nga lidhja e njohurive dhe mjeteve, të udhëhequr nga një kornizë strategjike diskutuese dhe të zbatuar përmes një mekanizmi të integruar e bashkërendues. Ndërsa mbetet të shihet nëse kjo rrugë e propozuar mund të arrihet në praktikë, përvoja e Kosovës ofron të paktën katër mësime të rëndësishme që mund të shërbejnë si pikë reflektimi për shoqëritë dhe kontekstet e tjera të prekura nga konflikti.

Mësimi 1: Nuk ka marrëveshje për paqe pa dispozita të drejtësisë tranzicionale

Shumica e marrëveshjeve të paqes në njëzet vitet e fundit kanë dispozita të qarta për drejtësinë tranzicionale.[169] Ndonëse ky është tregues i rëndësishëm i dinamikës së drejtësisë tranzicionale pas konfliktit, kjo nuk nënkupton suksese konkrete në trajtimin e të kaluarës. Sidoqoftë, siç ilustron rasti i Kosovës, transicionet pas konfliktit pa një marrëveshje paqësore dhe dispozita të qarta për drejtësinë tranzicionale mund t'i dëmtojnë përpjekjet afatgjata për t'u marrë me të kaluarën. Arsyeja zanafillore se pse Kosova nuk ka strategji nacionale për drejtësinë tranzicionale na kthen në vitin 1999, kur konflikti përfundoi pa një marrëveshje paqësore të pajtuar mes Serbisë dhe Kosovës. Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, e cila e mandatonte UNMIK-un të drejtonte transicionin e Kosovës nga lufta në statusin e saj të ardhshëm politik, ishte shumë e gjerë dhe nuk përmbante ndonjë dispozitë specifike për drejtësi tranzicionale. Midis 1999 dhe 2008, Kosova ishte nën administrimin e OKB-së, dhe bashkësia ndërkombëtare kishte fuqi të plotë politike e ligjore për të gjitha çështjet në Kosovë, përfshirë edhe drejtësinë tranzicionale. Sidoqoftë, në pritje të statusit politik të Kosovës dhe nga frika e rolit destabilizues që do të kishte ai në marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë, OKB dhe aktorët e tjerë ndërkombëtarë u përqendruan në ndjekjen penale të një numri të vogël të rasteve të krimeve të luftës, duke injoruar segmente të tjera të drejtësisë tranzicionale, si kërkimi i të vërtetës, dëmshpërblimet dhe garancitë e mospërsëritjes. Drejtësia penale ndërkombëtare dikur u bë më shumë mekanizëm për kontrollin e elitave etno-nacionaliste dhe qeverisjen e agjendave gjeopolitike, sesa për ndjekjen e drejtësisë tranzicionale dhe të interesave të viktimave.

Pas pavarësisë së Kosovës, BE pati mundësinë të bënte trysni mbi qeverinë e Kosovës për të nxjerrë një strategji kombëtare për drejtësinë tranzicionale. Sidoqoftë, ata kishin frikë se një strategji e tillë do ta rrënonte stabilitetin në Kosovë dhe t'ua prishte përpjekjet për të zgjidhur çështje të pazgjidhura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Rasti i Kosovës është pra shembull i mirë i dilemës së dhënies përparësi stabilitetit para se drejtësisë, çka në planin afatgjatë jo vetëm që rrënon legjitimitetin e bashkësisë ndërkombëtare, por rrezikon edhe t'i vonojë perspektivat për pajtimin etnik dhe jep shembull të keq për autoritetet kombëtare. Është edhe përkujtues i rëndësisë për përfshirjen e dispozitave mbi drejtësinë tranzicionale në marrëveshjet e paqes, duke u siguruar që shqetësimet afatshkurtra me stabilitetin të mos e lënë në hije rolin kritik të ofrimit të drejtësisë për komunitetet e prekura që të ruhet paqja. Për më tej, pasi Kosova dhe Serbia nuk nënshkruan një marrëveshje të paqes, çdo veprim i ndërmarrë nga autoritetet e Kosovës ose misionet ndërkombëtare për t'u marrë me të kaluarën ishte kryesisht masë e njëanshme, e përqëndruar në gjyqësorin. Për më shumë, kjo dëmtoi bashkëpunimin ndërkufitar juridik dhe gjyqësor në ndjekjen dhe gjykimin e të dyshuarve për krime lufte. E rrënoi edhe gatishmërinë e secilës palë për t'i identifikuar trupat e personave të zhdukur dhe për t'i bashkëndarë dokumentet e provat për krimet e kaluara. Më në fund, mungesa e një marrëveshjeje të paqes me dispozita të DT rrënoi gatishmërinë e secilit grup etnik për t'u përfshirë në aktivitete për trajtimin e të kaluarës, duke pasur frikë nga presioni brenda grupit dhe stigmatizimi. Kjo pastaj tkurri dialogun ndëretnik dhe hapësirën për pajtim.

169. Shih: PA-X (University of Edinburgh): Peace Agreements Database on transitional justice provisions. Gjendet në: https://www.peaceagreements.org/search?SearchForm%5Bregion%5D=&SearchForm%5Bcountry_entity%5D=&SearchForm%5Bname%5D=&SearchForm%5Bcategory_group%5D%5B%5D=10&SearchForm%5Bcategory_mode%5D=any&SearchForm%5Bagreement_text%_5D = & s = Kërko + Baza e të dhënave).

Mësimi 2: Koha dhe vullneti politik janë thelbësore për suksesin e proceseve të drejtësisë tranzicionale

Rasti i Kosovës ilustron edhe rolin përcaktues të kohës dhe të vullnetit politik kur trajtohet e kaluara. Përvoja e Kosovës tregon rëndësinë e përdorimit të momenteve të përshtatshme dhe të kohës së duhur për ndërmarrjen e përpjekjeve kombëtare për TsK. Duke kujtuar ngjarjet në Kosovë në dy dekadat e fundit, mund të argumentojmë sot se, nëse UNMIK përgjegjës për qeverisjen e Kosovës pas përfundimit të konfliktit, do të kish ndërmarrë masa të mjaftueshme strategjike, ligjore dhe institucionale për rregullimin e TsK në Kosovë, ndoshta trajektorja e zhvillimeve do të kish qenë më pozitive në drejtim të adresimit të çështjeve të trashëguara prej të kaluarës. Megjithatë, në rendin e prioriteteve, stabiliteti dhe shqetësimet afatshkurtra duket se kanë luajtur rol më të rëndësishëm se përparësia normative e të vërtetës, drejtësisë dhe njohjes për të gjitha komunitetet e prekura. Megjithëse administrata ndërkombëtare e Kosovës dha një shembull negativ për trajtimin e të kaluarës, vetë institucionet e Kosovës kishin mundësi të shumta për të hartuar një strategji kombëtare për drejtësinë tranzicionale. Historia e Kosovës tregon se mungesa e vullnetit politik ndërmjet grupeve politike kombëtare dhe etnike për të zbuluar të vërtetën dhe për të ofruar një masë drejtësie për të gjitha viktimat dhe të mbijetuarit, luante rol të madh në dështimin për qasje më të koordinuar, të integruar dhe gjithëpërfshirëse për ta trajtuar të kaluarën. Mungesa e vullnetit politik buronte nga një frikë midis elitave kombëtare se trajtimi i të kaluarës do t'ua rrënonte pushtetin dhe legjitimitetin politik. Kësaj frike i shtohej fakti se drejtësia tranzicionale në Kosovë lidhej më së shumti me ndjekjen penale për krime lufte. Meqë skena politike pas konfliktit në Kosovë është kontrolluar kryesisht nga parti dhe grupe politike që dikur ishin udhëheqës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), ata e kanë parë drejtësinë tranzicionale si gjueti politike dhe prandaj janë angazhuar për kërkimin e pjesshëm të të vërtetës, çka ua rriti kapitalin politik dhe popullaritetin.[170] Ndjekja e një agjende të paanshme dhe gjithëpërfshirëse për drejtësinë tranzicionale u pa si strategji e rrezikshme për mbijetesën e tyre politike dhe mbështetjen e tyre elektorale.[171] Në këto kushte, elitat kombëtare në Kosovë nuk kanë treguar ndonjë zotim për të trajtuar çështjet e trashëguara prej të kaluarës, përveç kur u përshtatet që t'i luftojnë kundërshtarët e vet politikë ose të gjenerojnë legjitimitet popullor.

Kosova nuk është rast i veçantë. Shembuj nga shoqëri të tjera të prekura nga konflikti tregojnë njëlloj se vullneti politik dhe gatishmëria e shoqërisë për t'u marrë me të kaluarën luajnë rol shumë më të madh në suksesin e drejtësisë tranzicionale sesa mendohet shpesh. Ndonëse Afganistani zhvilloi një strategji gjithëpërfshirëse të drejtësisë tranzicionale, mungesa e vullnetit politik dhe ndryshimet e mëvonshme politike e të sigurisë rezultuan me rrezikimin e përpjekjes për drejtësi dhe pajtim në atë vend.[172] Në Bosnjë e Hercegovinë, UNDP (Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim) mbështeti më 2010 një qeveri të përbashkët dhe nismën e shoqërisë civile për të zhvilluar një strategji kombëtare të drejtësisë tranzicionale. Me gjithë konsultimet e gjera me komunitetet e prekura, mosmarrëveshja politike midis palëve që përfaqësojnë tri komunitetet etnike konsitutive, rezultoi në dështimin e miratimit të strategjisë. Mbështetja në grupet e shoqërisë civile si mjeti kryesor për shpërndarjen e përmbajtjes së projekt-strategjisë te një popullsi më e gjerë nuk ka rezultuar në vetëdijesimin e gjerë publik dhe pranimin e strategjisë. Rrjedhimisht, strategjia nuk u zbatua kurrë.

170. Visoka, 'Arrested Truth'.

171. Visoka, Shaping Peace in Kosovo.

172. Shih: Tazreena Sajjad, "These Spaces in Between: The Afghanistan Independent Human Rights Commission and Its Role in Transitional Justice." International Journal of Transitional Justice Vol. 3, No. 3 (2009): 424-444.

Mësimi 3: Trajtimi i të kaluarës pa strategji rrënon proceset e drejtësisë tranzicionale

Agjendat e ndryshme të faktorëve ndërkombëtarë dhe kombëtarë, si dhe mungesa e mbështetjes politike, kanë çuar në shfaqjen e iniciativave krah për krah për trajtimin e të kaluarës në Kosovë. Analiza në këtë studim detajisht i shqyrtoi nismat kryesore për trajtimin e të kaluarës të cilat janë tipizuar nga: mungesa e konsensusit dhe kapacitetit se si të hartohen përgjigjet institucionale; mungesa e bashkërendimit dhe harmonizimit midis mbivendosjeve dhe nismave të ndryshme konkurruese; dhe më e rëndësishmja, mungesa e përfaqësimit të komuniteteve të prekura në proceset e vendimmarrjes për drejtësinë tranzicionale. Gjykimet ndërkombëtare, hibride dhe kombëtare për krimet e luftës kanë qenë të ngadalta dhe joefikase. Ato nuk ia kanë dalë të ofrojnë masë drejtësie për viktimat dhe të mbijetuarit. Padashtazi, meqë nuk shoqëroheshin nga mekanizma më të gjerë të drejtësisë tranzicionale, këto gjykime i kanë bërë më shumë dëm TsK-së shoqërore sesa kanë kontribuar për të vërtetën, drejtësinë dhe pajtimin. Në veçanti, pasi elitat kombëtare i kanë perceptuar proceset e drejtësisë tranzicionale si mjet gjeopolitik të bashkësisë ndërkombëtare për disiplinimin dhe kontrollin e tyre, ka pasur rezistencë lokale për t'u marrë në mënyrë gjithëpërfshirëse me çështjet e trashëguara prej konfliktit në Kosovë. Rrjedhimisht, përpjekjet institucionale të qeverisë së Kosovës ishin me gjysmë zemre dhe të kota. Nismat e drejtësisë tranzicionale janë shoqëruar me liderë politikë të caktuar dhe shpesh janë instrumentalizuar për interesa të ngushtë politikë.

Masat për trajtimin e të kaluarës ishin nga lart-poshtë dhe sporadike, me përfshirje të pamjaftueshme të komuniteteve të prekura. Për t'i kompensuar këto të meta, një grusht OJQ-sh me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë kanë ndërmarrë projekte për të kontribuar në thënien e të vërtetës dhe dokumentimin e vuajtjeve të kaluara, për të mbështetur komunitetet e prekura dhe për të monitoruar punën e institucioneve qeveritare dhe gjyqësore për çështje të drejtësisë tranzicionale. Ndërsa nismat me bazë tek OJQ-të kanë kompensuar pjesërisht mungesën e udhëheqjes serioze prej shtetit të drejtësisë tranzicionale, ato janë kritikuar për mungesë harmonizimi dhe për përfaqësim të drejtpërdrejtë të nevojave dhe interesave të komuniteteve të prekura. Për më shumë, të gjitha ato janë zbatuar në baza projektesh, pa vijimësi të qëndrueshme. Krahas iniciativave të udhëhequra nga shteti dhe nga OJQ-të, komunitetet e prekura janë organizuar rreth shoqatave të ndryshme të viktimave, të cilat shpesh kanë përfunduar duke u instrumentalizuar nga parti të ndryshme politike për agjendat e tyre elektorale dhe politike. Këto njohuri nga Kosova tregojnë se nismat krah për krah për drejtësi tranzicionale, pa një kornizë të duhur strategjike dhe infrastrukturë bashkëpunimi e bashkërendimi, sigurisht rrënojnë dhe zhvlerësojnë perspektivat për adresimin e duhur të çështjeve të trashëguara prej të kaluarës dhe ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë për komunitetet e prekura. Pasja e strategjisë dhe mekanizmave institucionale për të trajtuar të kaluarën nuk është recetë për drejtësi të suksesshme tranzicionale, por duke gjykuar nga mungesa e tyre në rastin e Kosovës, rëndësia e tyre nuk duhet të nënvlerësohet.

Mësimi 4: Qasjet diskutuese ndaj TsK janë kyçe për tejkalimin e bllokimeve ndaj të vërtetës dhe drejtësisë

Nismat e drejtësisë tranzicionale në Kosovë janë kryer me pak ose aspak përfshirje të komuniteteve të prekura. Nismat e shqyrtuara në këtë studim kanë qenë kryesisht nga lart poshtë, të dizajnuara nga ekspertë ndërkombëtarë dhe kombëtarë në bashkëpunim me një grusht OJQ-sh dhe shoqatash të viktimave. Përfshirja e shoqërisë civile dhe e shoqatave të viktimave shihet si e mjaftueshme për t'i shitur ato nisma si të udhëhequra lokalisht, si pjesëmarrëse dhe përfaqësuese të nevojave të komuniteteve të prekura. Veç kësaj, angazhimi i kufizuar i komuniteteve të prekura dhe i popullatës së përgjithshme ka rezultuar në kontestimin e gjerë dhe pakënaqësinë me proceset e drejtësisë tranzicionale.

Diskutimi i mëparshëm në këtë studim nxori në pah përfitimet e qasjeve diskutuese dhe pjesëmarrëse ndaj drejtësisë tranzicionale. Ndërsa Kosova ende mbetet t'i hyjë një udhëtimi drejt qasjeve më diskutuese për drejtësinë tranzicionale, është e vështirë të vlerësohet suksesi dhe rezultati i një qasjeje të tillë. Argumenti për drejtësinë tranzicionale të diskutuar është i fortë, sepse qasja e tillë nuk kërkon vetëm të prekë çështje të paadresuara nga e kaluara brenda dhe ndërmjet grupeve etnike, por edhe të krijojë një mjedis për mosdominim, respekt, njohje dhe paqe midis grupeve të ndryshme etnike, por edhe të gjenerojë legjitimitet për infrastrukturën institucionale për trajtimin e të kaluarës.[173] Drejtësia tranzicionale përmes metodave diskutuese dhe pjesëmarrëse ka më shumë gjasë të gjenerojë vullnet politik për ndryshim nga poshtë-lart. Kur liderët politikë të shohin konsensusin e gjerë popullor dhe përfshirjen në ndjekjen e aspekteve të ndryshme të drejtësisë tranzicionale, ka më shumë gjasë që ta përfshijnë atë në agjendën politike kombëtare. Presioni nga poshtë-lart dhe ligjshmëria mund të jenë siguri se institucionet shtetërore dhe strukturat e tjera përfaqësuese janë përgjegjës para komunitetit të prekur dhe qytetarëve të vendit. Për shembull, përvoja e Liberisë po tregon se sa e rëndësishme është për suksesin e strategjive kombëtare që t'i përfshijë komunitetet e prekura. Në vitin 2013, Qeveria e Liberisë propozoi 'Udhëzuesin Strategjik për Shërimin Kombëtar, Ndërtimin e Paqes dhe Pajtimin', që u hartua kryesisht nga konsulentët ndërkombëtarë me kontribut të kufizuar nga përfaqësuesit e shoqërisë civile. Ky proces anashkaloi edhe komunitetet e prekura më gjerësisht, por edhe humbi mundësinë për të adresuar shqetësimet e tyre socio-ekonomike, të cilat më pas rrënuan mbështetjen e publikut për procesin e trajtimit të të kaluarës, menaxhimin e të tashmes dhe planifikimin për të ardhmen.[174]

Megjithatë, mund të pohohet se çështja e hartimit dhe zbatimit të një strategjie kombëtare për drejtësi tranzicionale që u përgjigjet me përfshirje nevojave shoqërore, nuk është detyrë e lehtë për asnjë shtet dhe pak vende kanë provuar t'i integrojnë në mënyrë domethënëse nevojat e qytetarëve dhe komentet e tyre në një strategji të tillë. Ndërsa shoqëria civile duhet të luajë rol të rëndësishëm në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e strategjive të drejtësisë tranzicionale, ajo nuk duhet të jenë zëvendësim i një procesi të mirëfilltë konsultimi nga poshtë-lart, i cili duhet të përfshijë të gjitha komunitetet e prekura nga të gjitha etnitë, prejardhjet gjeografike dhe socio-ekonomike. Programet e depërtimit dhe fushatat kombëtare të vetëdijesimit për trajtimin e të kaluarës janë të rëndësishme përpara se të zhvillohen konsultimet, por mund të

173. James Bohman, 'Transnationalizing Peacebuilding: Transitional Justice as a Deliberative Process', in Larry May and Elizabeth Edenberg (eds.) Jus Post Bellum and Transitional Justice, Cambridge: Cambridge University Press. 2013, pp. 285-304.

174. Shih: Priyal Singh dhe Lesley Connolly, 'The Road to Reconciliation: A Case Study of Liberia's Reconciliation Roadmap', Umhlanga Rocks: ACCORD, 2014. Gjendet në: https://www.files.ethz.ch/isn/182036/ACCORD-policy-practice-brief-30.pdf.

mos i rrisin domosdoshmërisht njohuritë e komuniteteve të prekura. Politika e vendndodhjeve dhe hapësirave të konsultimit gjithashtu luan rol të madh në proceset e drejtësisë tranzicionale nga poshtë-lart. Konsultimet ku banojnë dhe punojnë komunitetet e prekura janë më domethënëse sesa ato që zhvillohen brenda institucioneve dhe hapësirave zyrtare.

Përveç çështjeve gjeografike, gjendja socio-ekonomike e kategorive të caktuara të viktimave, siç janë gratë, mund të ketë ndikim në gjithëpërfshirjen e konsultimeve lokale. OJQ-të ndonjëherë nuk arrijnë t'i kuptojnë ose t'i përfaqësojnë përparësitë e viktimave dhe të qytetarëve, duke shpalosur se përfshirja e grupeve të shoqërisë civile mund të mos çojë gjithmonë në përfaqësim më të madh të komuniteteve të prekura. Përvoja nga Nepali tregon se hulumtimi i aksionit pjesëmarrës, i kryer në komunitetet e prekura, gjeti se jo vetëm elitat, por edhe OJQ-të nuk arritën t'i përfaqësojnë përparësitë e viktimave, duke theksuar kështu se përfshirja e OJQ-ve në inxhinierimin e proceseve të drejtësisë tranzicionale mund të mos nënkuptojë gjithmonë përfaqësim më të madh dhe gjithëpërfshirje.[175] Prandaj, pjesëmarrja e komuniteteve të prekura në hartimin e politikave të drejtësisë tranzicionale nuk duhet të bëhet sa për sy e faqe. Pjesëmarrja nuk duhet të shfaqet vetëm para procesit të hartimit, por në të gjitha fazat e konceptimit, krijimit dhe zbatimit të masave përkatëse. Ndërsa përdorimi i metodave të drejtpërdrejta të konsultimit me komunitetet e prekura është thelbësor, duhen bërë përpjekje për të kuptuar në mënyrë gjithëpërfshirëse nevojat, interesat dhe preferencat e tyre, në vend të konsultimit sipërfaqësor me to, ose vendosjes së mekanizmave dhe qasjeve të përcaktuara jashtë, për t'u marrë me të kaluarën. Bashkësia ndërkombëtare dhe OJQ-të ndërkombëtare në këtë drejtim duhet të luajnë rol domethënës në mundësimin, mbështetjen dhe ofrimin e ndihmës për proceset nga poshtë-lart. Në veçanti, donatorët duhet të sigurohen që agjenda, procesi dhe rezultati i nismave të TsK të hartohen dhe të posedohen nga vetë komunitetet e prekura.

Më në fund, ky studim propozon një zhvendosje nga nismat e copëzuara për TsK drejt një infrastrukture institucionale të integruar, që do t'i bashkonte përpjekjet ekzistuese dhe të ardhshme për TsK në Kosovë. Koncepti i një infrastrukture për TsK do të ishte një aranzhim i përshtatshëm për Kosovën, për të siguruar një ekuilibër midis pavarësisë së nismave të ndryshme të TsK dhe rëndësisë për më shumë bashkërendim dhe bashkëpunim midis atyre nismave dhe në përputhje me një vizion të përbashkët strategjik e një kornizë për veprim. Më e rëndësishmja, infrastruktura për TsK do të ishte një adresë ku komunitetet e prekura do të përfshiheshin drejtpërdrejt në proceset e vendimmarrjes që prekin interesat dhe nevojat e tyre. Megjithatë, suksesi i saj varet nga vullneti politik dhe angazhimi i të gjithë aktorëve ndërkombëtarë dhe kombëtarë për t'i bashkuar burimet dhe për ta shtuar bashkërendimin për adresimin e çështjeve të trashëguara e të pazgjidhura të konfliktit dhe mbështetjen e [gjetjes së të vërtetës dhe] ndërtimit të besimit midis grupeve të ndryshme etnike, çka përfundimisht mund të rezultojë në pajtim.

175. Simon Robins dhe Ram Kumar Bhandari, 'From Victims to Actors: Mobilising victims to drive transitional justice process – A participatory action research project with families of the disappeared in Nepal', NEFAD, 2012. Gjendet në: https://nefad.files.wordpress.com/2012/06/nefad_from-victims-to-actors-research-report1.pdf.

Sint Jacobsstraat 12
3511 BS Utrecht
The Netherlands

www.paxforpeace.nl
info@paxforpeace.nl

+31 (0)30 233 33 46
P.O. Box 19318
3501 DH Utrecht
The Netherlands